

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5831
E premte, 19 korrik 2019
çmimi 0.40 €

Kryeministri pret në
takim përfaqësuesit
e Unionit të Bizneseve të
Diasporës | FAQE 9



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", FADIL MILLAKU | FAQE 4 - 5



Vendimi i KShC-së është i padrejtë dhe i ndikuar nga politika

Vendimi i KShC-së e ka dëmtuar shumë imazhin e Universitetit 'Haxhi Zeka'

Rektori i Universitetit Publik të Pejës "Haxhi Zeka", Fadil Millaku, e ka quajtur të padrejtë dhe të ndikuar nga politika vendimin e Këshillit Shtetëror të Cilësisë (KShC) për mosakreditimin e këtij universiteti. Ai ka bërë me dije se do të ankohen ndaj këtij vendimi pasi Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KShC) dhe Agjencia e Kosovës për Akreditim (AKA) kanë bërë shkelje me rastin e vendosjes së standardeve të reja për akreditim. Në këtë intervistë

dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka vlerësuar se vendimi i KShC-së e ka dëmtuar shumë imazhin e Universitetit "Haxhi Zeka" dhe, sipas Millakut, do të jetë vështirë të riparohet. Sidoqoftë, ai ka paralajmëruar se Universiteti "Haxhi Zeka" do t'i plotësojë standardet e reja të parapara që kanë të bëjnë me çështje akademike dhe cilësi kurse, sipas Millakut, standardet infrastrukturore do të mbeten në dorën e qeverisë

Haradinaj: Liberalizimi i vizave, çështje javësh

Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, beson se liberalizimi i vizave për qytetarët e Kosovës është çështje javësh. Ai ka bërë me dije të enjten se

lajmet e fundit janë se Kosova ka avancuar shumë në këtë drejtim. Sipas të parit të qeverisë, Kosova në këtë proces është më mirë sesa ka shpresuar | FAQE 3



Policia vazhdon aksionin për parandalimin e lojërave të fatit dhe bixhozit | FAQE 7

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepcisht-Tetovë
Curez-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

OPINION

**ARSIMIN E ORGANIZOJNË
DHE E DREJTOJNË
TË DITURIT, ATA QË DUAN TA
ARSIMOJNË E PËRPAROJNË
KOMBIN** F. 11

Shkruan: Jakup
KRASNIQI



AKTUALE

**REEKERI: KOSOVA DHE SERBIA
T'I RIKTHEHEN DIALOGUT** F. 5

**MË 3 GUSHT ZGJEDHET
KRYETARI I RI I LDK-së** F. 7

EKONOMI

**MINISTRI HAMZA: PRIORITET
I MINISTRISË SË FINANCAVE,
STABILITETI MAKRO-FISKAL
I VENDIT** F. 9

**PUNONJËSIT E 'TREPÇËS'
I MARRIN PAGAT PËR MUAJIN
QERSHOR** F. 8

KULTURË

**SHKRIMTARI
PËRBALLË
DIKTATURËS (3)**

Bedri ISLAMI



SPORT

**PREZANTOHET EKIPI
OLIMPIK, SYNOHEN
MEDALJE NË 'BAKU 2019'** F. 15



Rama vizitë në Turqi, takon presidentin turk

TIRANË, 18 KORRIK - Kryeministri Edi Rama ndodhet në një vizitë në Turqi, e pa paralajmëruar më parë.

Nëpërmjet një postimi në Instagram, Rama publikon një foto me presidentin e Turqisë, Rexhep Taip Erdogan, në rezidencën e tij verore në Marmaris.

"Në mikpritjen e presidentit Erdogan në rezidencën e tij verore në Marmaris", shkruan Rama.

Ende nuk dihet arsyeja e vizitës së kryeministrit shqiptar dhe as detaje të bisedës midis tyre.



Pacolli: Kosova është shembull në rajon për tolerancën fetare

Ministri i Jashtëm i Republikës së Kosovës, Behgjet Pacolli, në fjalimin e tij në Ministerialin mbi lirinë fetare që u organizua në Uashington, ka thënë se Kosova është një shembull në rajon dhe më gjerë në lidhje me tolerancën ndërfaqetare dhe bashkëjetesën e religjioneve



PRISHTINË, 18 KORRIK - Zëvendëskryeministri i parë dhe ministri i Punëve të Jashtme të Kosovës, Behgjet Pacolli, me ftesë të Sekretarit amerikan të Shtetit, Mike Pompeo, po merr pjesë në Ministerialin e lirinë fetare, ku po diskutohet mbi liritë fetare në mbarë botën.

Ministri Pacolli, në fjalimin e tij në Ministerialin mbi lirinë fetare që u organizua në Uashington, ka thënë se Kosova është një shembull në rajon dhe më gjerë në lidhje me tolerancën ndërfaqetare dhe bashkëjetesën e religjioneve. "Ne do të promovojmë këtë vlerë dhe trashëgiminë e Kosovës dhe jemi të lumtur ta ndajmë atë në mbarë botën. Ne do të vazhdojmë të punojmë me Qeverinë amerikane për të adresuar rëndësinë e lirinë fetare dhe për të marrë

iniciativa të përbashkëta me partnerët tanë", ka thënë Pacolli në konferencën, në të cilën, u diskutua për lirinë fetare, nga përfaqësuesit e 106 vendeve të botës.

Ai përmes një postimi në Facebook, tha se në këtë konferencë ka folur edhe për "mozaikun shumë-fetar dhe etnik të Kosovës".

"Në rrugëtimin tonë përpara ne duhet të shohim përsëri në traditën tonë të gjatë të bashkëjetesës paqësore midis feve të ndryshme, ne, myslimanët, katolikët, ortodoksët, protestantët, hebrenjtë dhe shumë komunitete të tjera jetojmë së bashku në harmoni dhe bashkëjetesë", ka thënë Pacolli.

"Në fjalimin tim në Ministerialin mbi liritë fetare të thirrur nga Sekretari amerikan i Shtetit paraqita mozaikun


multietnik dhe multifetar të Kosovës. Liria fetare është një parim që ka rëndësi për ne, për shkak të historisë sonë, trashëgimisë sonë dhe të ardhmes sonë. Në rrugëtimin tonë përpara ne duhet të shohim përsëri në traditën tonë të gjatë të bashkëjetesës paqësore midis feve të ndryshme, ne, myslimanët, katolikët, ortodoksët, protestantët, hebrenjtë dhe shumë komu-

nitete të tjera jetojmë së bashku në harmoni dhe bashkëjetesë, ka thënë ministri Pacolli. Ai ka thënë se Kushtetuta e Kosovës promovon praktikimin e pakufizuar të besimit dhe i jep trajtim të barabartë të gjitha feve në Kosovë dhe pasuesve të tyre.

"Ne kemi përfshirë instrumentet e Kombeve të Bashkuara dhe të Këshillit të Evropës si pjesë e sistemit tonë

ligjor. Aktualisht Parlamenti ynë është duke punuar për të miratuar një ligj modern mbi liritë dhe të drejtat fetare që i imponon këto instrumente ndërkombëtare dhe parimet tona kushtetuese në legjislationin kombëtar. Kosova po krijon mekanizma institucionale që do të forcojnë angazhimin e Qeverisë me të gjitha bashkësitë fetare në Kosovë", ka thënë Pacolli.

Meta: Rikthim urgjent i vendit në shinat e demokracisë dhe shtetit ligjor



TIRANË, 18 KORRIK - Presidenti i Shqipërisë Ilir Meta priti të enjten në një takim drejtorin e përgjithshëm të Ballkanit Perëndimor në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Mbretërisë së Bashkuar, ambasadorin Andrew Page me të cilin diskutoi lidhur me krizën në vend, si dhe mbi zhvillimet në rajon.

Presidenti Meta vlerësoi marrëdhëniet e shkëlqyera dypalëshe

ndërmjet Shqipërisë dhe Mbretërisë së Bashkuar, me bindjen se ato do të vijojnë të jenë edhe më dinamike në të ardhmen, veçanërisht në bashkëpunimin ekonomik e tregtar. Kreu i Shtetit mirëpriti angazhimin e shtuar të Britanisë së Madhe përmes burimeve njerëzore dhe financiare në ndihmë të 6 vendeve të Ballkanit Perëndimor në luftën kundër krimit të organizuar dhe

korruptionit, dhe për nxitjen e zhvillimit ekonomik, sikurse u premtua gjatë Samitit të Londrës. Presidenti Meta theksoi gjithashtu domosdoshmërinë e rikthimit urgjent të vendit në shinat e demokracisë dhe shtetit ligjor, duke i shërbyer njëkohësisht objektivit strategjik të çeljes së negociatave të anëtarësimit me Bashkimin Evropian gjatë takimit të Këshillit në tetor.

Basha: Qeveri transitore pa Ramën

TIRANË, 18 KORRIK - Lideri i Partisë Demokratike, Lulzim Basha ndodhet në Vjenë i shoqëruar nga disa kryetarë të partive aleate. Sipas asaj që njoftoi kreu i PD-së, ai ka zhvilluar

takime me përfaqësues të lartë të OSBE-së.

"Në Vjenë me përfaqësuesit e lartë të OSBE-së ndamë shqetësimin për krizën dhe qëndrimin e

pandryshuar të opozitës së bashkuar: zgjedhje të lira e të ndershme me një qeveri transitore pa Edi Ramën, që garanton lirinë e votës dhe ndëshkimin nga drejtësia të haj-

dutëve të zgjedhjeve", ka shkruar Basha.

Partia Demokratike dhe aleatët e saj nuk i njohin zgjedhjet e 30 qershorit dhe kërkojnë zgjedhjet tjetra në tetor.



Kryeministri Ramush Haradinaj vazhdon të besojë se liberalizimi i vizave për Kosovën është shumë afër

Haradinaj: Liberalizimi i vizave, çështje javësh

Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, beson se liberalizimi i vizave për qytetarët e Kosovës është çështje javësh. Ai ka bërë me dije të enjten se lajmet e fundit janë se Kosova ka avancuar shumë në këtë drejtim. Sipas të parit të qeverisë, Kosova në këtë proces është më mirë sesa ka shpresuar

**EPOKA
ERE****Muhamet KOÇI**

PRISHTINË, 18 KORRIK - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka bërë me dije se procesi i liberalizimit të vizave për qytetarët e Kosovës ka avancuar. Gjatë një vizite në Komunën e Fushë-Kosovës ai ka thënë të enjten se liberalizimi i vizave është çështje javësh. "Po dëgjojmë lajme të mira që procesi është shumë më përpara. Në vizitën e ministrit të Shëndetësisë të Gjermanisë, që është anëtar i kabinetit të kancelares Merkel, Jens Spahn, e kemi diskutuar këtë çështje. Mendoj se kjo çështje është më mirë sesa kemi shpresuar", ka thënë Haradinaj. Sipas tij, Kosovën në këtë proces do ta ndihmojë edhe kryesuesja e re e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen. "Kryesuesja e komisionit është gjermane. Gjermanët kanë marrë një iniciativë dhe kjo është çështje javësh. E di se disa po thonë mos po nxitohesh kryeministër, por ne jemi vonuar. Pra, është çështje javësh kur të marrim këtë lajm të merituar (liberalizimin e vizave). E meritojmë liberalizimin sepse i kemi përmbushur të gjitha kriteret", ka deklaruar kryeministri Haradinaj.

Ai ka folur edhe për procesin e anëtarësimit të Kosovës në Interpol. Ai ka treguar se Kosova edhe zyrtarisht është në rend të ditës si temë, por ende nuk ka hyrë në rend të ditës votimi për anëtarësim. "Ne jemi në rend dite si temë, por ende nuk ka hyrë në rend të ditës çështja e votimit. Sot me shkrim e kam marrë konfirmimin prej Drejtorisë së Interpolit që është në Lion, se jemi pjesë e disku-

timit, por ende nuk është vendosur çështja e hyrjes në votim", është shprehur Haradinaj.

I pari i qeverisë ka treguar se shumë shpejt institucionet e Kosovës do të diskutojnë nëse do të aplikohet këtë vit për anëtarësim në Interpol. Më 20 nëntor të vitit 2018, Kosova nuk kishte arritur të anëtarësohet në Interpol, pasi që nuk mori shumicën e nevojshme, prej dy të tretave të votave të vendeve pjesëmarrëse në Asambleenë e Përgjithshme të kësaj organizate që u mbajt në Dubai.

Kryeministri i premtuar mbështetje Fushë-Kosovës

Kryeministri i Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj, ka vizituar të enjten Komunën e Fushë-Kosovës, ku kryetari të kësaj komune, Burim Berisha, i ka premtuar mbështetje. Me këtë rast Haradinaj ka thënë se është një mundësi e mirë që t'i shprehë respektin dhe përgëzimin për angazhimin në punë kryetari të Fushë-Kosovës. "Kryetari shpjegoi se popullsia është rritur shumë shpejt në Fushë-Kosovë dhe kjo ka sjellë plot implikime të tjera, mirëpo është fat i madh se qeveria komunale dhe kryetari kanë arritur t'i përcjellin këta trendë", ka deklaruar Haradinaj.

Ai ka thënë se janë disa kërkesa që kërkojnë ndërhyrjen e qeverisë nacionale në këtë komunë, siç janë hartat zonale që janë të nevojshme. "Pastaj çështja e komunikacionit dhe kalimit përmes qytetit për të cilin është i nevojshëm edhe një



rrethrotullim, trafostacioni që është në proces dhe shpresoj se do të kryhet shpejt trajtimi i ujërave të zeza dhe çështja e pronave, sepse Fushë-Kosova vuan për mungesë të pronave që t'i ketë në shfrytëzim për

interesa të komunës", ka deklaruar Haradinaj, duke bërë me dije se i ka premtuar kryetari Berisha se këto detyra që i mori nga afër do t'i procedojë në kohën më të shpejtë të mundur. Kurse kryetari i

Komunës së Fushë-Kosovës, Burim Berisha, ka thënë se ishte kënaqësi për të që kryeministri Haradinaj ta vizitojë këtë komunë, për të biseduar rreth disa temave të rëndësishme për qytetarët dhe komunën.

Lekaj dhe policia takohen për segmentin rrugor Zahaq - Hyrja e Pejës

PRISHTINË, 18 KORRIK (ER) - Ministri i Infrastrukturrës dhe Transportit, Pal Lekaj, të enjten ka pritur në takim përfaqësuesit e Policisë së Kosovës nga Drejtoria e Trafikut Rrugor Qendror dhe Njësi nga Peja. Lekaj ka ftuar këtë takim në mes të organeve të rendit dhe

ekspertëve të MIT-së për harmonizim të veprimeve për plotësimin e kërkesave të qytetarëve të Pejës për kycje në rrugën nacionale Pejë - Prishtinë (Zahaq).

Me qëllim të gjetjes së zgjidhjeve pa penguar mbarëvajtjen dhe sig-

urinë në trafikun rrugor, një ekip i përbashkët i MIT-së dhe policisë do të jenë në terr të premtën. Ministri Lekaj ka ritheksuar këmbëngulësinë e tij që të gjenden pranë qytetarëve me infrastrukturën e duhur, sa herë që kërkesat e tyre janë të arsyeshme.



Flet për "Epokën e re", Fadil Millaku

Vendimi i KShC-së është i padr

Vendimi i KShC-së e ka dëmtuar shumë imazhin e Universitetit 'Haxhi Zeka'



Rektori i Universitetit Publik të Pejës "Haxhi Zeka", Fadil Millaku, e ka quajtur të padrejtë dhe të ndikuar nga politika vendimin e Këshillit Shtetëror të Cilësisë (KShC) për mosakreditimin e këtij universiteti. Ai ka bërë me dije se do të ankohen ndaj këtij vendimi pasi Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KShC) dhe Agjencia e Kosovës për Akreditim (AKA) kanë bërë shkelje me rastin e vendosjes së standardeve të reja për akreditim. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka vlerësuar se vendimi i KShC-së e ka dëmtuar shumë imazhin e Universitetit "Haxhi Zeka" dhe, sipas Millakut, do të jetë vështirë të riparohet. Sidoqoftë, ai ka paralajmëruar se Universiteti "Haxhi Zeka" do t'i plotësojë standardet e reja të parapara që kanë të bëjnë me çështje akademike dhe cilësi kurse, sipas Millakut, standardet infrastrukurore do të mbeten në dorën e qeverisë

EPOKA E RE

Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 18 KORRIK - Rektori i Universitetit Publik të Pejës "Haxhi Zeka", Fadil Millaku, të enjten ka paralajmëruar ankesë ndaj vendimit të Këshillit Shtetëror të Cilësisë (KShC) për mosakreditimin e këtij universiteti. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se ky vendim nuk është i drejtë, por i ndikuar nga politika. "Vendimi i Këshillit Shtetëror të Cilësisë (KShC) nuk është i drejtë dhe mendoj se është i ndikuar nga politika. Po,

do të ankohemi në momentin që Universiteti 'Haxhi Zeka' pranon vendimin nga Këshilli Shtetëror i Cilësisë. Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KShC) dhe Agjencia e Kosovës për Akreditim (AKA) kanë bërë shkelje me rastin e vendosjes së standardeve të reja për akreditim", ka deklaruar Millaku, duke hedhur dyshime se ekspertja nga Rumania ka qenë subjektive dhe nuk ka pasur sjellje akademike. "Universiteti 'Haxhi Zeka' ka pasur akreditim institucional dhe akreditim të programeve studimore. Ekspertët e jashtëm që kanë

ardhur për t'i vlerësuar programet studimore kanë dhënë vlerësim pozitiv për të gjitha programet studimore, me përjashtim të një programi në studimet master. Këtu qëndron dyshimi se ekspertja nga Rumania ka qenë subjektive dhe nuk ka pasur sjellje akademike. Si është e mundur që programet studimore të akreditohen dhe të vlerësohen shumë mirë. Domethënë sipas ekspertëve të tjerë të jashtëm, programet studimore i plotësojnë kriteret për t'u akredituar deri 89 për qind, ndërsa një eksperte e vetme nga një shtet

'ejtë dhe i ndikuar nga politika

Shtetëror i Cilësisë (KShC) e ka dëmtuar shumë imazhin e Universitetit 'Haxhi Zeka'. Kjo vështirë do të riparohet", ka theksuar Millaku. Sidoqoftë, ai ka paralajmëruar se Universiteti "Haxhi Zeka" do t'i plotësojë standardet e reja të parapara që kanë të bëjnë me çështje akademike dhe cilësi kurse, sipas Millakut, standardet infrastrukture do të mbeten në dorën e qeverisë. "Standardet që kanë të bëjnë me infrastrukturë përcjellëse si: fushat sportive, konviktet, mensa e studentëve dhe bufet në kuadër të kompleksit mbeten në dorën e qeverisë sepse për t'u plotësuar edhe këto standarde Qeveria e Kosovës duhet të investojë në infrastrukturë. Këto standarde nuk i plotëson asnjë universitet publik në Kosovë, besoj as në rajon", ka thënë rektori Millaku.

"Epoka e re": Z. Millaku, Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KShC) ka marrë vendim që Universiteti Publik i Pejës "Haxhi Zeka" të mos ketë të drejtë të pranohet studentë të rinj këtë vit. Si e komentoni këtë vendim?

Millaku: Vendimi i Këshillit Shtetëror i Cilësisë (KShC) nuk është i drejtë dhe mendoj se është i ndikuar nga politika.

"Epoka e re": A do të ankoheni ndaj këtij vendimi dhe mbi çfarë baze do të bëhet ankesa meqë vlerësimi është kryer nga ekspertë ndërkombëtarë?

Millaku: Po, do të ankoheja në momentin që Universiteti 'Haxhi Zeka' pranon vendimin nga Këshilli Shtetëror i Cilësisë. Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KShC) dhe Agjencia e Kosovës për Akreditim (AKA) kanë bërë shkelje me rastin e vendosjes së standardeve të reja për akreditim. Këto standarde dhe manuali për t'i shkruar Raportet e Vetëvlerësimit (RVV) janë dërguar në institucionin tonë më 21 shtator 2018. Universiteti 'Haxhi Zeka' është dashur që t'i plotësojë Raportet e Vetëvlerësimit (RVV) deri kah fundi i dhjetorit të vitit 2018. Për plotësimin e standardeve të reja AKA-ja dhe KShC-ja është dashur që Institucioneve të Arsimit të Lartë (IAL) me u dhënë kohë të paktën 1-3 vjet që të mbahen trajnime dhe, sipas këtyre standardeve, të përgatiten dokumentet përcjellëse: Plani strategjik, rregulloret, kodi i etikës dhe shumë dokumente të tjera përcjellëse që kërkohen sipas standardeve të reja të miratuara nga KShC-ja. AKA-ja për akreditim institucional ka dërguar vetëm një ekspert të jashtëm dhe një student. Meqenëse kemi pasur në akreditim me shumë së 12 programe është dashur që numri i

ekspertëve të jashtëm të jetë të paktën tre e më shumë. Ekspertja e jashtme ka krijuar vetë këto standarde dhe ka ardhur t'i vlerësojë të njëjtat, që mund të jetë edhe konflikt interesi. Parashtrrohet pyetja: Si është e mundur që fati i një universiteti publik të mbetet në dorën e një individi? Vendimin për apo mosakreditim e merr KShC-ja, ndërsa eksperti i jashtëm vetëm rekomandon.

"Epoka e re": Cilat kanë qenë kushtet që nuk i keni plotësuar si universitet për t'iu akredituar programet?

Millaku: Universiteti 'Haxhi Zeka' ka pasur akreditim institucional dhe akreditim të programeve studimore. Ekspertët e jashtëm që kanë ardhur për t'i vlerësuar programet studimore kanë dhënë vlerësim pozitiv për të gjitha programet studimore, me përjashtim të një programi në studimet master. Këtu qëndron dyshimi se ekspertja nga Rumania ka qenë subjektive dhe nuk ka pasur sjellje akademike. Si është e mundur

që programet studimore të akreditohen dhe të vlerësohen shumë mirë?! Domethënë, sipas ekspertëve të tjerë të jashtëm, programet studimore i plotësojnë kriteret për t'u akredituar deri 89 për qind, ndërsa një eksperte e vetme nga një shtet që nuk e ka njohur Kosovën si shtet të jep rekomandim negativ.

"Epoka e re": Mendoni se një vendim i tillë është bërë që studentët të drejtohen kah Universiteti i Prishtinës dhe kolegjet private?

Millaku: Përafërsisht Universiteti i Mitrovicës, i Pejës dhe i Prizrenit në vitin e parë regjistrojnë rreth 8 000 studentë. Besoj se kjo nuk do koment.

"Epoka e re": Në fakt, vendimi i KShC-së a do të ketë efekt negativ në raport me studentët në kuptimin që ata të mos vijnë për të studiuar në Universitetin 'Haxhi Zeka'?

Millaku: Vendimi i Këshillit Shtetëror i Cilësisë (KShC) e ka dëmtuar shumë imazhin e

Universitetit 'Haxhi Zeka'. Kjo vështirë do të riparohet.

"Epoka e re": Z. Millaku, që nga themelimi i këtij universiteti dhe universiteteve të tjera publike është kontestuar cilësia e tyre dhe vendimi i fundit i KShC-së po e konfirmon një gjë të tillë. Çfarë do të bëni për ngritjen e cilësisë në këtë universitet dhe a rrezikon që edhe vitin tjetër ky institucion të mosakreditohet?

Millaku: Gjithmonë ka vend për t'u përmirësuar sepse jemi universitete të reja. Universiteti 'Haxhi Zeka' do t'i plotësojë standardet e reja të parapara dhe që kanë të bëjnë me çështje akademike, cilësi etj. Standardet që kanë të bëjnë me infrastrukturë përcjellëse si: fushat sportive, konviktet, mensa e studentëve dhe bufet në kuadër të kompleksit mbeten në dorën e qeverisë sepse për t'u plotësuar edhe këto standarde Qeveria e Kosovës duhet të investojë në infrastrukturë. Këto standarde nuk i plotëson asnjë universitet publik në Kosovë, besoj as në rajon.

Reekeri: Kosova dhe Serbia t'i rikthehen dialogut

PRISHTINË, 18 KORRIK - Shtetet e Bashkuara janë të gatshme të kycen në procesin e dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, por këtë nuk mund ta bëjnë, përderisa të dyja palët nuk vendosin t'i rikthehen dialogut, ka thënë ndihmëssekretari amerikan i Shtetit, Philip Reeker, raporton Zëri i Amerikës në gjuhën serbe. "Shtetet e Bashkuara janë absolutisht të gatshme të përfshihen (në dialog), kam folur për këtë me sekretarin e Shtetit, Mike Pompeo. Ne duam të shohim një ndryshim. Por, ne nuk mund

ta bëjmë këtë për ju. Kosova dhe Serbia duhet të vendosin së bashku rreth gatishmërisë së tyre për t'u kthyer në dialog. Ne punojmë ngushtë me partnerët e BE-së", ka thënë Reeker. Zyrtaari më i lartë i Departamentit të Shtetit, që merret me Ballkanin, tha se beson se ka gatishmëri për të gjetur një zgjidhje nga të dyja anët dhe kështu të kontribuojnë në stabilitetin dhe prosperitetin e Ballkanit Perëndimor. "Unë inkurajoj që Serbia dhe Kosova të gjejnë një mënyrë dhe të kthehen në negociata, kështu

do ta kenë mbështetjen e plotë të Shteteve të Bashkuara dhe partnerëve tanë në Evropë për të arritur një marrëveshje përfundimtare nëpërmjet dialogut. Unë e di se mund ta bëjnë këtë", ka thënë Reeker.

Diplomati amerikan si një "model për zgjidhjen e çështjeve në rajon", përmendi shembullin e udhëheqësve të Greqisë dhe Maqedonisë së Veriut të cilët arritën një marrëveshje për emrin. Ai vlerësoi se sfidat e rajonit mund të kapërcehen me mbështetjen e ShBA-së dhe BE-së.

që nuk e ka njohur Kosovën shtet të jep rekomandim negativ", është shprehur ai.

Rektori Millaku ka vlerësuar se vendimi i KShC-së e ka dëmtuar shumë imazhin e Universitetit 'Haxhi Zeka' dhe, sipas tij, do të jetë vështirë të riparohet. Ai nuk e ka përjashtuar mundësinë që një vendim i tillë të jetë marrë për ta rikthyer vëmendjen e studentëve kah Universiteti i Prishtinës dhe kolegjet private. "Përafërsisht Universiteti i Mitrovicës, i Pejës dhe i Prizrenit në vitin e parë regjistrojnë rreth 8 000 studentë. Besoj se kjo nuk do koment. Vendimi i Këshillit



Rasti i vëllezërve Bytyçi 'duhet t'i përcaktojë' marrëdhëniet ShBA - Serbi

PRISHTINË, 18 KORRIK - Komiteti për Punë të Jashtme i Kongresit të Shteteve të Bashkuara miratoi një rezolutë, me të cilën i bëhet thirrje Serbisë t'i sjellë para drejtësisë vrasësit e tre vëllezërve Bytyçi, shtetas amerikanë, me prejardhje nga Kosova. Në rezolutë thuhet se përparimi për zgjidhjen e këtij rasti "do të duhej të ishte faktor i rëndësishëm që përcakton zhvillimin e mëtejshëm të marrëdhënieve ShBA-Serbi". "Shtetet e Bashkuara duhet t'u kushtojnë vëmendje përpjekjeve të Qeverisë së Serbisë dhe ministrave të saj përkatës si dhe zyrtarëve të tjerë, të cilët po ndërmarin hapa për të hetuar dhe ndjekur penalisht personat që besohet se janë përgjegjës për vrasjen e vëllezërve Bytyçi. Përparimi në zgjidhjen e këtij rasti, ose mungesa e vullnetit, duhet të jenë faktor i rëndësishëm në përcaktimin e zhvillimit të ardhshëm të marrëdhënieve midis ShBA-së dhe Serbisë", thuhet në dokument. Vëllezërit Agron, Mehmet dhe Yll Bytyçi janë arrestuar në vitin 1999 në Serbi, për shkak të, siç

kanë thënë zyrtarët serbë, kalimit të paligjshëm të kufirit. Ata janë liruar nga burgu pasi janë dënauar dhe më pas janë vrarë. Trupat e tyre janë gjetur në një varr masiv, pranë Petrovo Sello në lindje të Serbisë, në vitin 2001.

Dy policë të akuzuar për ndihmë në likuidimin e vëllezërve Bytyçi, Sreten Popović dhe Millosh Stojanović, janë shpallur të pafajshëm me vendim të Gjykatës së Lartë në Beograd për krime lufte.

Gjykata ka thënë se nuk ka prova për përfshirjen e tyre në vrasjet e kryera në korrik të vitit 1999. "Është e papranueshme që asnjë person nuk është gjetur fajtor për ekzekutimin e vëllezërve Bytyçi apo ndonjë krim tjetër që lidhet me vdekjen e tyre dhe që askush nuk përballet me akuza për këtë krim. Qeveria e Serbisë dhe ministritë dhe zyrat e saj përkatëse, përfshirë edhe Prokurorinë për Krime Lufte të Serbisë, duhet ta vënë prioritet hetimin dhe ndjekjen penale të zyrtarëve që besohet se janë përgjegjës për këto vdekje", thuhet po ashtu në rezolutë.



Duke shpjeguar arsyet përse vëmendja duhet përqendruar në këtë rast, teksti i rezolutës përmend zyrtarë të Republikës Federale të Jugosllavisë, që nga koha e luftës në Kosovë, të cilët ose janë dënauar për krime lufte përpara Tribunalit të Hagës, ose kanë vdekur.

Në rezolutë, po ashtu, thuhet se Goran Radosavljeviq Guri, ish-

komandant i xhandarmërisë serbe, punon këshilltar për një kompani në Beograd dhe se është "anëtar i shquar" i partisë në pushtet [Partisë Përparimtare Serbe].

Rezoluta e njëjtë është miratuar nga Komiteti për Punë të Jashtme edhe një vit më parë, por duhej të kthehej pasi sesioni i ri i Kongresit ka nisur në fillim të vitit

2019. Edhe kryetari i këtij komiteti, Eliot Engel, u ka bërë thirrje autoriteteve në Serbi që sa më parë ta zgjidhin rastin e vëllezërve Bytyçi.

Në një intervistë për "Radion Evropa e Lirë", më 4 korrik, Engel ka thënë se e inkurajon presidentin e Serbisë, Aleksandar Vučić, sepse "vetëm ai mund të bëjë ndonjë lëvizje". (REL)

Nënshkruhet deklarata për promovimin e dialogut ndërmjet komuniteteve



EPOKA E RE Qendresa RAMA

MITROVICË, 18 KORRIK - Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, Misioni në Kosovë (OSBE), të enjten ka organizuar ceremoninë zyrtare të nënshkrimit të deklaratës së përbashkët për ta promovuar dialogun ndërmjet komuniteteve në Komunën e Mitrovicës, Vushtrrisë, Skenderajt dhe Podujevës. Në këtë ceremoni i pranishëm ishte drejtori i Administratës nga Komuna e Mitrovicës, Hysen Muzliukaj, kryetari i Komunës së

Podujevës, Agim Veliu, kryetari i Komunës së Vushtrrisë, Xhafer Tahiri, drejtori për Kulturë, Rini dhe Sport nga komuna e Skenderajt, Ramiz Shala, përfaqësues të komuniteteve, zyrtarë komunalë si dhe përfaqësues të organizatave joqeveritare.

Në fjalën e tij, ambasadori Jan Braathu, shef i Misionit të OSBE-së në Kosovë, ka falënderuar kryetarët e komunave dhe drejtorët të cilët ishin të pranishëm në këtë ceremoni, duke thënë se është i kënaqur që mund ta ndihmojë bashkëpunimin

ndërkomunal për promovimin e çështjeve të komuniteteve. Me këtë rast, drejtori i Administratës, Hysen Muzliukaj, para nënshkrimit të deklaratës për zotimet e komunave për bashkëpunim ndërkomunal, ka thënë se Komuna e Mitrovicës çdo ditë e më shumë po angazhohet ta përmirësojë jetën dhe mirëqenien e qytetarëve mitrovicës nga të gjitha komunitetet. "Komuna e Mitrovicës në vazhdimësi është përpjekur që të gjitha komunitetet të cilat jetojnë në qytetin tonë të përfaqësohen sa më denjësisht, duke realizuar

edhe projekte të ndryshme për integrimin e tyre dhe rregullimin e infrastrukturës rrugore. Ndërsa Zyra Komonale për Komunitetet dhe Kthim është ajo e cila ka dhënë kontribut të veçantë për identifikimin e kërkesave dhe realizimin e projekteve të ndryshme për komunitetet që jetojnë në Mitrovicë", ka thënë drejtori Muzliukaj. Ai ka shtuar se kryetari dhe komuna si institucion kanë treguar gatishmëri të lartë për të nënshkruar këtë deklaratë dhe me përgjegjësinë më të lartë t'i përmbushin edhe rekomandimet e dala nga kjo

deklaratë.

Kryetarët e komunave u deklaruan se qëllimi i nënshkrimit ka të bëjë me promovimin e dialogut dhe respektimin ndërmjet komuniteteve në komunat tona, po ashtu edhe në tërë Kosovën. Duke kujtuar se një shoqëri me shumëllojshmëri kulturore është një qëllim që duhet ndjekur dhe se ndërtimi i institucioneve është po aq i rëndësishëm sa edhe krijimi i bashkëpunimit gjithnjë e më të afërt në të gjitha fushat dhe në respekt të të gjitha komuniteteve.

FSK-ja po avancohet sipas standardeve të NATO-s

PRISHTINË, 18 KORRIK (ER) - Kryeministri i Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj, ka zhvilluar të enjten një takim me komandantin suprem të Forcave Aleate të NATO-s për Evropë (SACEUR), gjeneralin Tod D. Wolters, me të cilin ka biseduar për zhvillimet e përgjithshme dhe situatën e sigurisë në Kosovë, rajon dhe më gjerë.

Kryeministri Haradinaj e ka njoftuar gjeneralin Wolters për të arriturat e institucioneve

të Kosovës në të gjitha fushat, veçmas në atë të sigurisë, duke theksuar orientimin properëndimor dhe euroatlantik të Kosovës. Me këtë rast, kryeministri Haradinaj ka falënderuar gjeneralin Wolters dhe NATO-n për mbështetjen e Kosovës në të gjitha proceset dhe për misionin e tyre për krijimin dhe forcimin e paqes dhe sigurisë në Kosovë dhe më gjerë, në të njëjtën kohë ka kërkuar mbështetjen e mëtejme për avancimin dhe

profesionalizmin e Forcës së Sigurisë së Kosovës. "Kosova është e rreshtuar me ushtritë e lirisë e të paqes dhe se FSK-ja shumetnike dhe profesionale po avancohet sipas standardeve të NATO-s, si ofruese e sigurisë në vend dhe rajon", ka thënë kryeministri Haradinaj, duke theksuar se Kosova në aspiratën e saj për anëtarësim në Paktin Veri-Atlantik është konsistente dhe e gatshme të kontribuojë për paqen aty ku kërkohet nga ShBA-ja dhe NATO.



Policia vazhdon aksionin për parandalimin e lojërave të fatit dhe bixhozit

Policia e Kosovës ka shtuar përpjekjet e saj për parandalimin e zhvillimit të aktiviteteve që ndërlidhen me lojërat e fatit dhe bixhozit të paligjshëm.

Policia në disa komuna, pas bastisjeve, ka konfiskuar disa shtëpiza, TV, DVD kompjuterike dhe telefona

**EPOKA
ERE**

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 18 KORRIK - Policia e Kosovës (PK), konkretisht Njësi i Hetimeve Kundër Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit në Gjilan, më 16 korrik ka ekzekutuar urdhër kontrollor në lokalitë të dyshuarit (A. S.) në qytetin e Vitisë për shkak të dyshimit të bazuar se merret me 'organizimin e lojërave të fatit dhe bixhozit të paligjshëm'.

Gjatë kontrollit tek lokali i të dyshuarit të lartshënuar janë gjetur dhe janë konfiskuar shtatë shtëpiza, gjashtë TV, një DVD kompjuterike, një telefon mobil 'Samsung' të cilat do të shërbejnë si dëshmi relevante për rastin. "I dyshuari i lartshënuar me rastin e kontrollit të lokalitë të tij nuk është paraqitur në vendin e ngjarjes si pronar, duke i ikur përgjegjësisë", është thënë në njoftimin e policisë. Në rastin e dytë, më 17 korrik, Policia e Kosovës ka ndaluar të dyshuarin në fshatin Dobresh-Viti dhe i njëjti është shoqëruar në polici për procedura të mëtejme. Sipas

policisë, i dyshuari është intervistuar dhe me aktvendim të prokurorit kompetent i është caktuar masa e ndalimit për 48 orë. Po ashtu, më 17 korrik Njësia Rajonale për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit në Prizren, në bashkëpunim dhe bashkërendim të aktiviteteve me Qendrën Rajonale Operative, si dhe Njësitë për Reagim të Shpejtë të Drejtorisë Rajonale të Policisë në Prizren, kanë ndër-marrë veprime hetimore dhe operacionale, pasi që dyshohej se në Prizren, në një lokal pa emër, janë duke u zhvilluar lojëra të fatit të cilat janë të ndaluara me ligj. "Pas kryerjes së veprimeve hetimore, ku është përgjigjur edhe Njësia për Luftimin e Krimeve Kibernetike, në koordinim të plotë dhe me autorizim verbal të prokurorit kompetent të Prokurorisë Themelore të Prizren, është konfiskuar aparatura e hasur në lokalitë në fjalë, dy shtëpiza dhe tre monitorë. Dy të dyshuar në këtë rast, një menaxher dhe një punëtor në këtë lokal, janë intervistuar dhe në konsultim me



prokurorin sipas procedurës së rregullt është iniciuar rasti", është theksuar në njoftimin e policisë.

Përderisa në Vushtrri më 17 korrik është raportuar se Njësi i Hetimeve të Krimit të Organizuar në kuadër të Policisë së Kosovës ka arrestuar një të dyshuar, pasi që i njëjti ka

zhvilluar veprimtari të kundërligjshme të lojërave të fatit, ndërsa gjatë kontrollit në lokalitë të tij janë gjetur dhe konfiskuar si prova materiale nëntë aparate të lojërave, ndërsa lokali i është mbyllur nga inspektorati kompetent. I dyshuari, pas intervistimit, është dërguar në mbajtje, përderisa rasti vazhdon të

hetohet.

Policia e Kosovës ka njoftuar se mbetet e përkushtuar dhe vazhdon realizimin e detyrave dhe autorizimeve të saj ligjore, identifikimin e kryerësve të veprave të ndryshme penale dhe sjelljen para organeve të drejtësisë të të gjithë atyre që bien ndesh me rregullat dhe procedurat ligjore.

Më 3 gusht zgjedhet kryetari i ri i LDK-së

PRISHTINË, 18 KORRIK (ER) - Nën udhëheqjen e kryetarit të Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Isa Mustafa, të enjten është mbajtur takim me kryetarët e degëve të kësaj partie. Sipas njoftimit të LDK-së, në takim u diskutua rreth përmbjlljes së procesit zgjedhor brenda LDK-së që do

të kulmojë me Kuvendin e LDK-së më 3 gusht ku do të zgjedhet kryetari dhe Këshilli i Përgjithshëm. "Këto organe udhëheqëse do ta përgatisin LDK-në, në ndërlidhje të ngushtë me qytetarët e Kosovës, për fitoret e radhës në zgjedhjet lokale dhe qendrore për t'u dhënë vizion dhe orien-

tim temave të mëdha me të cilat po ballafaqohet Kosova. Kuvendi i LDK-së do të ketë karakter solemn ku do të rikonfirmohet puna dhe performanca e LDK-së, fuqia politike dhe lidhja e fuqishme tridhjetëvjeçare e LDK-së me popullin e Kosovës", është thënë në njoftimin e LDK-së.



Lladrovci: Drenasi u ofron siguri bizneseve italiane

DRENAS, 18 KORRIK (ER) - Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, ka pritur në takim komandantin e Njësitit të Specializuar Shumëkombësh (MSU), Ruggiero Capodivento dhe stafin e tij. Në takim kryetari Lladrovci e ka njoftuar komandantin Capodivento për punën që bëhet në Komunën e Drenasit si dhe është diskutuar për mundësitë, interesimin dhe sig-

urinë që kjo komunë ka dhe ua ka ofruar bizneseve të interesuara italiane. Ndërsa komandanti Capodivento e ka falënderuar kryetarin Lladrovci për mikpritjen si dhe ka diskutuar më të për ndeshjen miqësore në mes të Feronikelit dhe Milanos që do të luhet më 10 gusht. Më tutje, ai e ka ftuar kryetarin Lladrovci për një vizitë në bazën e tyre në Prishtinë. Në fund të

takimit janë shkëmbyer edhe dhuratat, ku komandanti Capodivento ia ka dhuruar kryetarit Lladrovci simbolin me logon e njësitit të tij, ndërsa ky i fundit, pasi ka njoftuar mysafirët për punën organizatës joqeveritare "Qendra për Promovimin e Drejtave të Grave" në Drenas, ua ka dhuruar atyre nga një medaljon punim dore nga anëtarët e kësaj OJQ-je.



Zyrtarët e Komunës së Prishtinës certifikohen për njohuritë bazike të integrimit evropian

PRISHTINË, 18 KORRIK (ER) - Zyrtarët e Komunës së Prishtinës janë certifikuar për njohuritë bazike të procesit të integrimit evropian, obligimet që burojnë nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimit (MSA) dhe procedurat e aplikimit në fondet e Bashkimit Evropian për komunat. Siç ka njoftuar

kjo komunë, ky trajnim do t'i ndihmojë zyrtarët që të informohen për hapat e përbushjes së kriterëve të procesit të integrimit në Bashkimin Evropian në nivel lokal të qeverisjes dhe raportimit të drejtë të përbushjes së kriterëve të MSA-së mbi të arriturat e Komunës së



Prishtinës. Me këtë rast, komuna e drejtuar nga Shpend Ahmeti ka falënderuar

Bashkimin Evropian, Zyrën e BE-së në Kosovë, Këshillin Britanik në Kosovë dhe

European Young Cell Association për mbështetjen në këtë projekt.

Vihet gurthemeli për ndërtimin e sallës sportive në shkollën 'Haxhi Hoti' në Rogovë



GJAKOVË, 18 KORRIK (ER) - Ministri i Arsimit, Shyqiri Bytyqi, ka vënë të enjten gurthemelin për ndërtimin e sallës së edukatës fizike në Shkollën Fillore dhe të Mesme të Ulët "Haxhi Hoti" në Rogovë të Gjakovës. Ai ka thënë se një vit më parë kishte dhënë zotimin se këtë shkollë do ta bëjnë me sallë sportive. "Është kënaqësi kur realizohen premtimet e dhëna për kushte më të mira në arsim. Sot, një vit më pas, bashkë me deputetin e zonës Veton Berisha, zëvendësministrin Artan Berisha, kreun e Nismës në Gjakovë, Fazli

Hoxha dhe drejtues të tjerë të Komunës së Gjakovës, kemi vënë gurthemelin e sallës së edukatës fizike në shkollën që me krenari e mban emrin e dëshmorit Haxhi Hoti. Ndihej i nderuar dhe shumë i kënaqur për jetësimin e një premtimi të dhënë një vit më parë, mbi të gjitha i kënaqur për faktin se nxënësit meritojnë që t'u krijojmë kushte sa më të mira, që të përjetojnë standarde si gjithë të rinjtë të tjerë", ka thënë ministri Bytyqi, duke shtuar se do të vënë sa më shumë gurëthemele të shkollave dhe sallave të reja me standarde perëndimore.

Një delegacion i Komunës së Mitrovicës po qëndron për vizitë zyrtare në Turqi

MITROVICË, 18 KORRIK (ER) - Një delegacion i Komunës së Mitrovicës, në përbërje me kryetarin e komunës Agim Bahtiri, drejtori për Kulturë, Rini dhe Sport, Tafil Peci, drejtori për Mbrojtje dhe Shpëtim, Nehat Bahtiri, si dhe drejtori për Arsim, Iset Beka, po qëndrojnë për një vizitë zyrtare në komunën Inegyl të Turqisë.

Gjatë vizitës që delegacioni i komunës sonë po realizon në

qytetin e Inegylit të Turqisë është pritur nga kryetari i komunës Alper Taban. Me këtë rast, kryetari i komunës, Agim Bahtiri, ka falënderuar kryetarin Taban për mikpritjen dhe për bashkëpunimin që ai ka me komunitetin shqiptar që jeton në këtë komunë.

Po ashtu, kryetari Bahtiri ka zhvilluar një takim po aq të rëndësishëm edhe me kryetarin e Odës Ekonomike, me të cilin ndau për-

voja dhe ide për formën e të bërit biznes si dhe sfidat dhe vështirësitë që janë në këtë fushë. Bashkëbiseduesit u pajtuan që bashkëpunimi të thellohet edhe më shumë në të ardhmen dhe, përveç bashkëpunimit në fushën e kulturës, të zgjerohet edhe në fusha të tjera, sidomos për realizimin e projekteve të ndryshme zhvillimore dhe ekonomike, për çka u tha se të dyja komunat kanë potencial të mirë.



Kryeministri pret në takim përfaqësuesit e Unionit të Bizneseve të Diasporës



PRISHTINË, 18 KORRIK (ER) - Kryeministri Ramush Haradinaj ka pritur të enjten në takim kryetarin e Unionit të Bizneseve të Diasporës në

Gjermani, Nazmi Viqa, dhe Vllaznim Kelmendin, drejtor për financa dhe marketing. Haradinaj përmes një postimi në llogarinë e vet në

"Facebook" ka shkruar se me Nazmi Viqën dhe Vllaznim Kelmendin ka biseduar për mundësitë që afaristët kosovarë ta

investojnë kapitalin e tyre edhe në Kosovë. "Falënderues për sipërmarrësit e diasporës që po punojnë bashkë për një

zhvillim dinamik të Kosovës dhe në këtë drejtim qeverinë do ta kenë partner të përhershëm", ka shkruar Haradinaj.

Ministri Hamza: Prioritet i Ministrisë së Financave, stabiliteti makro-fiskal i vendit

EPOKA E RE

A. MAVRAJ

PRISHTINË, 18 KORRIK - "Prioritet i Ministrisë së Financave në procesin e planifikimit të buxhetit për vitin 2020-2022 është stabiliteti makro-fiskal i vendit dhe në këtë drejtim objektivat tona permanente konsistojnë në harmonizimin e të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore", ka thënë të enjten ministri i Financave, Bedri Hamza, gjatë takimit me përfaqësuesit e Komunitetit të Gjiçanit, Komunitetit të Vitisë, Shtërpcës, Ranillugut, Kaçanikut, Hanit të Elezit, Parteshit, Kllokotit, Ferizajt, si dhe Komunitetit të Novobërdës.

Ky takim është mbajtur në kuadër të forumeve me autoritetet komunale lidhur me zhvillimin e procesit buxhetor komunal për periudhën 2020-2022, të organizuara nga Ministria e Financave, në bashkëpunim me OSBE-në, të cilat kanë filluar që nga data 12

korrik 2019 dhe janë zhvilluar me të gjitha komunat e Kosovës. Ministri Bedri Hamza ka theksuar para të pranishmëve se qëllimi i këtij takimi është që të informohen zyrtarët e komunave mbi procesin buxhetor komunal për vitin 2020-2022 si dhe për koordinimin e aktiviteteve mbi zhvillimin e planifikimit afatmesëm të buxhetit komunal të përcaktuar me kuadrin ligjor, me theks të veçantë do të diskutohet mbi Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve për vitin 2020-2022, Qarkoren Buxhetore 2020/01, Strukturën e Shpenzimeve, si dhe Projektligjin për Financat e Pushtetit Lokal. "Korniza për buxhetin e vitit 2020 bazohet në KASH 2020-2022 që është aprovuar nga Qeveria e Kosovës bazuar në prioritetet afatmesme të qeverisë dhe kornizën makro-fiskale për vitet 2020-2022. Gjatë zhvillimit të procesit buxhetor janë marrë parasysh edhe zotimet tona në raport me institucionet financiare ndërkombëtare.



Në këtë kontekst, Qarkorja Buxhetore 2020/01 është hartuar në pajtim me obligimet nga marrëveshjet financiare ekzistuese dhe të atyre në negociim dhe reflekton në drejtimin e politikave fiskale të përcaktuara në pajtim me Fondin Monetar Ndërkombëtar", ka thënë ministri Hamza.

Ai me këtë rast ka bërë me dije se ndarjet e granteve qeveritare për komuna për vitin 2020 janë bërë sipas kriterëve dhe formulave të përcaktuara në Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal dhe ligjet e tjera relevante, si dhe duke u bazuar në projeksionet makro-fiskale dhe të dhënat nga ministrinë e linjës. Sipas ministrit Hamza,

financimi komunal për vitin 2020 është aprovuar nga Komisioni i Granteve në shumën rreth 580 milionë euro. Gjatë takimit, ministri Hamza gjithashtu u ka bërë thirrje komunave që ta rrisin inkasimin e të hyrave të tyre vetjake, ku përmes tyre mund të realizojnë projekte kapitale të cilat ngritin mirëqenienë qytetarëve të tyre.

Punonjësit e "Trepçës" i marrin pagat për muajin qershor

PRISHTINË, 18 KORRIK - Më 18 korrik punëtorëve të "Trepçës" u kanë dalë pagat për muajin qershor. Lajmin e ka konfir-

muar për gazetën "Epoka e re" kryesuesi i Bordit të "Trepçës", Ardian Syla. "Të enjten janë paguar pagat për muajin qer-

shor 2019. Ka pasur vonesa në përmbushjen e obligimeve të pagave të cilat kanë qenë evidente gjatë muajve paraprakë

për shkak të prodhimit të ulët me të cilin po ballafaqohet "Trepça" në vitet e fundit", ka deklaruar Syla. (A. MAVRAJ)



Fizika simetrike, udhëtim drejt universit (4)

Pozicioni i trupave qiellorë në rrugën e qumështit



Shkruan: Naim KRASNIQI, fizikan

Vrimën në diskut e hapur e vendosim vertikalisht mbi një sipërfaqe. Tani në mes të vrimës e vendosim një sferë metalike (shih figurën 19 a). Sapo sfera hyn në vrimën cilindrike ajo magnetizohet dhe mbetet në brendësi të vrimës, duke anuar pak nga polet magnetike të veriut (N). Kjo sferë e hekurit (Fe) me çfarëdo lëvizje poshtë-lart të diskut nuk del nga vrima, ajo mund të largohet vetëm nën veprimin e një force të jashtme. Në rastin e dytë e largojmë sferën cilindrike, dhe në të njëjtën mënyrë në vrimën eksperimentale, e vendosim një sferë të magnetizuar me pole (N S) prapë se prapë ajo do të mbetet në brendësi të vrimës eksperimentale, duke anuar pak nga polet magnetike të veriut (N), pa marrë parasysh se sfera posedon një fushë magnetike.

Argumente

Meqenëse e gjithë hapësira ku ndodhet sistemi ynë diellor është e mbushur me fusha magnetike të shumë trupave qiellorë qoftë Diellit, Jupiterit, Saturnit, Uranit Neptunit, Plutonit, por edhe fusha të trupave të tjerë qiellorë që kanë fusha magnetike dhe ndodhen në një hapësirë të njëjtë, atëherë çdo trup që në përbërjen e tij ka materiale ferromagnetike apo vetë është i magnetizuar do të mbetet brenda kësaj hapësire, por njëkohësisht e stabilizon rrotullimin e atij trupi rreth orbitave të tyre. Kjo na jep të kuptojmë se trupat qiellorë brenda një galaksie nuk rrinë të gjithë në një vijë aty ku intensiteti i cikloneve të galaksive është më i lartë, por shpërndahen mbi këtë vijë, dhe ndër këtë vijë varësisht nga forma dhe intensiteti i fushave magnetike që burojnë nga trupat qiellorë.

Kurse, arsyeja se pse sfera qoftë e hekurit (Fe) apo sfera e magnetizuar, rrinë më afër poleve magnetike të veriut (N), ndodhë nga fakti se sfera e cila ndodhet në fushat magnetike ajo magnetizohet me një fushë magnetike ((B))?. Në këtë rast fusha që buron nga polet magnetike të magnetëve (N) është shumë herë më e madhe se fusha magnetike që buron nga poli magnetik i sferës (S), prandaj sferat e magnetizuara dhe ato magnetike rrinë më afër poleve të veriut (N) (shih figurën 20 a). Bazuar në këtë eksperiment, mund të themi se Dielli te i cili ndërrojnë polet magnetike çdo 11 vite kalon nga qendra e galaksisë herë mbi anën e sipërme e herë në anën e poshtme të ciklonit të galaksisë, i cili fenomen shkakton lëvizje zinxhirore edhe te trupat e tjerë qiellorë (shih figurën 20 b).

Elementet joferromagnetike nuk kanë asnjë ndikim te trupat qiellorë





Eksperimenti numër 3

Diskun e kthejmë në formë vertikale, kurse në brendësi të vrimës eksperimentale e vendosim një sferë të hekurit (Fe). Kuptohet, kjo sferë magnetizohet me një fushë magnetike ((B)) ?sapo të hynë në vrimën eksperimentale. Tani mbi polet magnetike të cilit do qoftë magnet cilindrik (N 1 S 1), vendosim pllakat materialeve joferromagnetike, qoftë të aluminit të bronzit apo çfarëdo materiali që nuk është ferromagnetik.

Do të vërtetohet se sfera nuk do të lëvizë aspak dhe do të mbetet në të njëjtën pozitive si me prezencën e pllakave, si pa prezencën e tyre. Në rastin e dytë, nëse në vend të sferës së hekurit (Fe) vendosim një sferë të magnetizuar me fushë magnetike ((B)) ?prapëseprapësfera e magnetizuar nuk do të lëvizë aspak nga pozita e saj. (shih figurën 21). Ky eksperiment ndër lidhet me prezencën e materialeve joferromagnetike që ndodhen mbi polet magnetike të trupave qiellorë.

Përfundim

Prezenca e materialeve jo ferromagnetike mbi polet magnetike të çfarëdo magneti, nuk ka asnjë efekt mbi sferën e hekurit (Fe) apo sferën e magnetizuar që ndodhet brenda vrimës eksperimentale. Prandaj prezenca e materialeve jo ferromagnetike, qoftë e dheut, shkëmbinjve, ujërave apo gazrave mbi polet magnetike, qoftë Tokës, Diellit apo cilit do trup qiellorë që pose-



don fushë magnetike nuk kanë asnjë efekt mbi këtë fushë.

Pozicioni i Hënës në fushën magnetike të tokës

Eksperimenti numër 4

Në eksperimentin e tjetër, në vend të pllakave jo ferromagnetike, qoftë të bronzit apo aluminit mbi polet magnetike të të njëjtit magnet i vendosim pllakat e hekurit (Fe), do të shohim se sfera e hekurit (Fe) nuk qëndron në gjendjen e mëparshme, por ajo do të largohet nga ky pozicion dhe do të ngritët lart.

Madje edhe nëse tentojmë me forcë që ta kthejmë në pozitën e mëparshme, ajo prapë se prapë sapo të ndërpritet forca e veprimit, sfera do të largohet dhe do të qëndrojë lart ashtu siç shihet në (shih figurën 22). Ky eksperiment na jep të kuptojmë se prezenca e materialeve të hekurit (Fe) mbi polet magnetike të cilitdo trup qiellor që ka një fushë magnetike, ashtu sikur ka Toka, reagon me forcë shtytëse mbi trupat e tjerë qiellorë që nuk kanë fusha magnetike, ashtu sikur Hëna nuk posedon fushë magnetike.

Pozicioni i Tokës në fushën magnetike të Diellit

Eksperimenti numër 5

Në vrimën eksperimentale tani në vend të sferës së hekurit (Fe), e vendosim një sferë të magnetizuar që posedon një fushë magnetike ((B)) ?, kurse

në të njëjtën mënyrë mbi polet magnetike të njërit magnet (N1S1) vendosim të njëjtat pllaka të hekurit (Fe), do të shohim se në të njëjtën mënyrë, por edhe më lehtësisht sfera magnetike do të zhvendoset ashtu sikur sfera e hekurit (Fe), dhe do të ngritët lart në të njëjtën pozitive qoftë në anën e majtë apo të djathtë, pa marrë parasysh se kjo sferë ka një fushë të vetën magnetike ((B)) - dhe vendoset në fushat magnetike të shumë magnetëve permanente ?((B)) - (shih figurën 23).

Përfundim

Prezenca e materialeve ferromagnetike mbi polet magnetike të çfarëdo magneti, shkakton reagime mbi sferën e hekurit (Fe) apo sferën e magnetizuar që ndodhet brenda vrimës eksperimentale. Ky eksperiment na jep të kuptojmë se prezenca e materialeve të hekurit (Fe) mbi polet magnetike të cilitdo trup qiellor që ka një fushë magnetike ashtu sikur ka Toka, reagon me forcë shtytëse mbi trupat e tjerë qiellorë që kanë fusha magnetike, ashtu siç kanë fusha magnetike Toka, Jupiteri, Saturni, Urani dhe Neptuni

Pse ndodh ky fenomen i jashtëzakonshëm?

Këtë fenomen të jashtëzakonshëm të veprimit të forcave të ndryshme në një hapësirë ku prezentë gjenden fusha të ndryshme magnetike ?((B)) ?, por edhe materiale të llojeve të

ndryshme, shkenca asnjëherë nuk e ka njohur, por as nuk e ka vërtetuar. Kështu mund të themi se ky fenomen është një fenomen i ri në shkencë dhe totalisht i panjohur për shkencën e tanishme. Sado të mendojmë se kjo shkencë ka avancuar, prapë se prapë shkenca dhe teknologjia në disa pika kanë mbetur në vlerën zero absolute. Arsyeja se pse ndodh ky fenomen i jashtëzakonshëm, do të sqarohet pjesë pas pjesë, përmes shembujve sa më të thjeshtë dhe më të kuptueshëm për të gjithë lexuesit. Sido që të jetë, këto fenomene të panjohura për shkencën, janë çelësi kryesor i zbulimeve të sekreteve që ndodhin në Univers.

Rritja enigmatike e fushës magnetike në brendësinë e trupave qiellorë

Eksperiment 6

Tani le ta marrim të njëjtin magnet permanent cilindrik, që posedon në polet magnetike një intensitet të fushës magnetike prej 320 mT. Kurse në mes të magnetit cilindrik, aparaturo na tregon një intensitet prej 210 mT (shih figurën 24 a)

Në të dy pllakat e hekurit (A B) bëjmë një çarje për të futur në brendësi aparaturore matëse të intensitetit të fushës magnetike.

Këto dy pllaka i vendosim mbi polet e magnetit në formë cilindrike, dhe e llogaritim intensitetin e fushës magnetike në mes pllakave të hekurit (A B) dhe poleve magnetike (N S). Eksperimentalisht do të vërtetohet se kemi një rritje të intensitetit të fushës magnetike në polet e magnetit, nga 320 mT në rreth 500 mT, që i bie se intensiteti i fushës magnetike ((B)) ?pasi të vendosen pllakat e hekurit (Fe) mbi polet magnetike (N S) është rritur rreth 56 për qind apo 1.56 herë më i lartë.

Edhe përkundër asaj se pllakat e hekurit (Fe) polarizohen, eksperimenti e vërteton se nga të dy polet magnetike të pllakave të hekurit (Fe) do të del intensiteti i fushës magnetike në vlerën e 17 mT, çka do të thotë se nga të dy polet magnetike (N S) të pllakave të hekurit (Fe), që janë në kontakt direkt me polet magnetike të magnetëve, intensiteti i fushës magnetike ka vlerën 19 herë më të vogël (shih figurën 24 b). **Vijon.**

ARSIMIN E ORGANIZOJNË DHE E DREJTOJNË TË DITURIT, ATA QË DUAN TA ARSIMOJNË E PËRPAROJNË KOMBIN



**Shkruan: Jakup
KRASNIQI**

Një vendim i ligjshëm apo i paligjshëm qoftë, në shoqërinë tonë me të drejtë ka nxitur një debat. Nuk është edhe aq e rëndësishme se çfarë është përmbajtja e debatit, e rëndësishme është gjendja në arsimin tonë në përgjithësi e në atë të lartit në veçanti. Cila është kjo gjendje dhe a mundet kjo gjendje t'i përshkruhet një ministri të urtë e të kulturuar, siç është ministri Bytyqi? Jo! Kur problemet i kanë krijuar të tjerët ndër vite, askush nuk thotë pse krijuam shumë mami (lexo institucione të pavarura), për ta mbytur arsimin e lartë? Populli thotë: "Shumë mami e mbysin foshnjën"! Arsimit tonë i janë bërë shumë mami të varura e të "pavarura", prandaj arsimit ynë në përgjithësi, e sidomos arsimit

i lartë, nuk mund të kishte fat tjetër nga ky që po e vajtojmë pas njëzet vjetësh.

Kur filloi kriza, sidomos në arsimin e lartë?

Kriza në arsimin tonë filloi atëherë kur, pa u rehabilituar procesi arsimor që ishte i dëmtuar rëndë nga Serbia e Millosheviqit, sidomos në fillim të viteve të '90-ta të shekullit XX u kalua në sistemin e Bolonjës. Pas këtij kalimi (a thua i gabuar?!), gabimi tjetër i madh u bë me liberalizimin e arsimit - hapja e universiteteve private pa asnjë kriter të vetëm dhe pa asnjë mekanizëm që kontrollon performancën dhe cilësinë e tij. Në fakt, universitetet private, tani kolegje, nuk kishin për qëllim arsimin cilësor, por për biznesin privat thjesht përfitimin material. Këto universitete kanë filluar në baraka dhe shikoni ndonjërin prej tyre se ku kanë përfunduar. Askush në qeveritë tona të pasluftës nuk është kujdesur për cilësinë në ato universitete a kolegje private. As institucioni i pavarur - KShC - që me ligj i është dhënë ajo

përgjegjësi, përkundrazi, po nga ai institucion janë privilegjuar dhe privilegjuen edhe tani kolegjet private (le ta themi disa). Si paska mundësi një institucion i pavarur me 5 a 7 veta mbi bazën e një rekomandimi të ndonjë "eksperti" të jashtëm t'i mbyllë njëherësh tri universitete publike? Pastaj t'i mbyllë edhe disa kolegje private, e t'i privilegjojë vetëm ato që kanë shumë para? Gjërat nuk janë kaq të thjeshta siç po shihen nga disa. Sidomos nga ata që e mbështeten KSHC-në! Situata e krijuar e obligon Kuvendin e Kosovës dhe Qeverinë që ta shikojnë seriozisht infrastrukturën ligjore ekzistuese. A është e duhura? A duhet ndryshuar? Para se Qeveria e Kosovës të ndërhyjë në vendimin e ngutshëm të një organi të pavarur, ajo duhet urgjentisht se bashku me Kuvendin ta ndryshojnë ligjin dhe përgjegjësinë në arsimin e lartë ta marrë shteti - Qeveria. Përndryshe, cili është roli i Qeverisë dhe i Ministrisë së Arsimit në këtë situatë? Si kryetar i Kuvendit, dihet kjo tashmë botërisht, kam qenë kundër krijimit të univer-

siteteve publike për vota, pa asnjë analizë a elaborat të studiuar mirë, por atëherë opozita heshtte, heshtte se edhe ajo llogariste në vota. Në demokraci votat janë të rëndësishme, por jo për të shkelur mbi interesin e kombit e të shtetit. Tani universitetet publike janë aty dhe për to duhet të vendosin Kuvendi dhe Qeveria, të mbyllën apo t'ju krijohen kushtet për vazhdimin e aktivitetit studimor. Në një situatë të tillë, Qeveria nuk duhet të flasë se universitetet publike duhet të ekzistojnë për çështje sociale, ajo, para se të ndajë para për autostrada, le të ndajë para për arsimin nëse e ka prioritet, për kryeautostradën e kombit (arsimin), për të tërhequr kuadrot e duhura e jo ta shkelë ligjin që është në fuqi. Ligji duhet ndryshuar e pastaj vijnë veprimet e duhura te institucioneve përkatëse. Qeveria dhe Ministria e Arsimit duhet të krijojnë një trupë profesionale për t'i kontrolluar të gjithë trupat e deritashme të institucioneve të pavarura apo të Shoqërisë Civile që kanë përfituar nga përgjegjësitë që i kanë pasur ose u janë dhuruar

për "ngritjen" e cilësisë, sa ato e paskan ngritur gjatë viteve cilësinë në arsimin e lartë! Në situatën e krijuar një gjë shihet e dihet! Po zhurmojnë shumë pikërisht ata që deri tani kanë përfituar shumë nga arsimit i lartë, dhe pikërisht pse ky arsim i lartë nuk ka pasur zot shtëpie të përcaktuar qartë! Gjendja në arsimin tonë seç ma kujtoi thënie e malësore lidhur me vështirësinë për të mbajtur shtëpi: "Mos me kanë për mend e dije, por me kanë për fuqi, Kola i jem i kishte mbajtur tri"! Mbase para qindra viteve, malësorja e jonë e pashkollë e ka ditur se dija e jo fuqia udhëheq me familjen. Prandaj, aq më pak arsimin e bëjnë të fuqishmit apo përfituesit e shumtë që i janë sulur atij nga të gjitha anët për zhvatje! Si përfundim: Arsimin e organizojnë dhe e drejtojnë jo përfituesit pa parime, por të diturit, të arsimuarit, njerëzit me integritet, ata që qëllim parësor kanë për të arsimuar dhe edukuar të ardhmen e kombit, për ta zhvilluar e përparuar vendin! Kosova pikërisht për këtë ka nevojë imediate!

DJALLI APO KUSH PO NA MBËRTHEN ME U SHA MES VETE?



**Salihe SALIHU,
PhD kandidat dhe
veprimtare**

Bashkimi bën fuqinë ishte një frazë që u shndërrua në hit vitin e kaluar, gjatë zgjedhjeve lokale dhe kjo frazë m'u shpikë sot në kokë jo për t'u rikthyer te përdorimi i njëjtë i kësaj fraze, por për ta kapur temën rreth diskutit helmues që ka përfshirë shqiptarët e Kosovës dhe më gjerë. Diskursi politik helmues kohët e fundit që u lansua është rreth debatit buxhovician (Jusuf Buxhovi) që mori dhenë, dhe u shndërrua në hipertemë jo vetëm në gazeta e portale mediatike, por edhe në biseda me njëri-tjetrin e që shkaktoi

defekte saqë edhe lukthi gurgullonte vrer nga helmi i absorbuar. Hipotetikisht mund të them se ndoshta krejt kjo atmosferë u krijua për të dëshmuar se ne jemi aktivë në shoqëri, nuk dalim jashtë me u rrezitë e mu përvëlur nën rreze të diellit, por i hidhemi njëri-tjetrit dhe i nximë nervat ma shpejt se nga temperaturat natyrore. Ndërsa dëshmia tjetër mund të jetë e konektuar me paraqitjen e fuqisë efektive se neve nuk na ndal askush, bile nuk mërzhitemi fare për pasojat që mund t'i shkaktojë ky lloj debati i kavërdist bukur gjatë, por që është pa fije kripte. Shtrohet pyetja se çfarë zori patëm t'i hyjmë këtij debati dhe shumë debateve të tjera që momentalisht janë shumë të infektuara dhe aspak të dobishme as për njërin palë e as për tjetrën. Athu djalli na ka hyrë në palcë e po na sillt e mbërthen kah po dëshiron vetë? Mund t'i vargojmë disa njohuri

që edhe një analfabet i di e leje më ndonjë që e ka vizituar bankën e shkollës apo ka lexuar ndonjë notis ndonjëherë. Të gjithë e dimë që Kosova ka rezistuar nëpër të gjitha fazat gjatë okupimit, por rezistenca ka variuar në forma të ndryshme. Një ndër format e njohura janë grupet kaçake rezistuese, protestues e demonstrues, grupet ilegale të organizuara për rezistencë, rezistenca paqësore dhe finalja dhe që ishte produktivja ishte forma e rezistencës aktive me armë në duar e udhëhequr nga UÇK-ja. Pa hyrë në shpjegime shkencore apo në ndonjë përshkrim kronologjik mund të potencojmë se secili grup dhe secila formë e ka rëndësinë e vet për kontributin e dhënë. Përpos kësaj të gjithë e dimë që rezistenca paqësore është përkrahur edhe nga vetë liderët e ilegales, me shpresë se do t'i shmangemi luftës pasi që ish-sistemi komunist pati pësuar goditje vdekjeprurëse dhe me

këtë disfatë ne shqiptarët e gjerë besonim se do të jetë një mundësi apo shansi i fundit që me rënien e këtij sistemi njëkohësisht do të mund të çliroheshim edhe nga pushtimi. Shpejt u kuptua si ky mendim ishte iluzionar dhe vetë-mashtim që nuk shpinte askund tjetër përpos drejt nënshtrimit total ndaj okupimit. Ky vetëdijësim ishte një nxitje thelbësore për t'u aktivizuar masivisht dhe rrjedhimisht përcaktimi për ta themeluar UÇK-në. Kjo ishte arritja më e fuqishme që dha rezultatet faktike drejt çlirim të Kosovës. Prandaj në përgjithësi çështjet janë shumë të njohura dhe nuk është e drejtë që të shtrembërohen, devijohen, apo të përplasen sa andej e sa këndeje këto kontribute. Për ta përmbyll këtë temë dëshiroj të apeloj tek të gjithë se më mirë është të merremi më shumë me punë e obligime që janë më imperative për shtetin tonë sepse askush nuk mund t'i kryejë punët tona më

mirë se ne vetë, prandaj duhet t'u japim prioritet maksimal këtyre detyrave. Në këtë kontekst, vlen të potencohet që vendet me traditë të fortë demokratike gjatë viteve të fundit e kanë forcuar disiplinën e diskutit të tyre si në të shprehur, po ashtu edhe në të shkruar, që të mos bien preh e propagandës rusofile. Sistemi propagandues rus ka marrë dimensione globale dhe është duke u konsideruar si kërcënim i nivelit ndërkombëtar. Ky rrezik na është vërshuar edhe në Kosovë e gjetiu në treva shqiptare, kështu që ne të gjithë duhet ta vendosim gjuhën në kandar/peshore për t'i matur fjalët tona dhe shkrimet tona. Maturia në këto momente është një masë parandaluese që do të na ndihmonte që të frenohemi e të reflektojmë se athua mos djalli po na zvarrit nëpër mjegull apo kah po dëshiron ai vetë për të na turbulluar nga përgjegjësitë tona për vendin tonë.



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA DRENAS
Zyra e Kryetarit
Udhëheqësi i Personelit
01Nr. 111/21-41292 dt. 18/07/2019



Në bazë të nenit 11 paragrafi 1, nenit 18, paragrafi 1 të Ligjit Nr.03/L-149 të Shërbimit Civil të Republikës së Kosovës, Ligjit nr.04/L-032 Për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Ligjit nr.03/L-068 Për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës dhe në bazë të nenit 2 paragrafi 7 të Udhëzimit Administrativ të MASHT-it, nr.08/2014 për procedurat dhe kriteret e zgjedhjes së Drejtorit dhe Zv.Drejtorit të institucionit edukativo-arsimor dhe aftësues, Sektori i Burimeve Njerëzore, Komuna e Drenasit, shpallë këtë:

KONKURS PUBLIK PËR PLOTËSIMIN E POZITËS SË PUNËS

DREJTORIA E ARSIMIT

I.Titulli i vendit të punës: **Drejtör shkollë fillore të mesme të Ulët (SHFMU)**
„Halil Bajraktari” Drenasi II

Lloji i vendit të punës: **Me mandat**
Numri i Pozitave: **1 (një) pozitë**
Kategoria Funktionale: **Nivël drejtues**
Koefficienti: **7.8**
Kohëzgjatja e emërimit: **Katër (4) vjet**

Qëllimi i vendit të punës:

Udhëheqja, menaxhimi dhe mbikëqyrja e institucionit edukativo-arsimor

DETYRAT KRYESORE TË PUNËS:

- Menaxhimin dhe administrimin e përgjithshëm të institucionit;
- Hartimin e planit vjetor të punës dhe planit zhvillimor të institucionit, të cilin e miraton Këshilli drejtues i shkollës;
- Kordinimin dhe bashkëpunimin me aktivet profesionale për ndarjen e normave dhe orëve për mësimdhënës/edukatorë, caktimin e kujdestarëve të klasave, kujdestarëve të dites si dhe kërkim raportim prej tyre;
- Caktimin e detyrave për zgjedhjen, vlerësimin, disiplinën dhe çështjet tjera që kanë të bëjnë me mësimdhënësit dhe punëtorët tjerë edukativo-arsimor, konform legjislacionit në fuqi si dhe caktimi dhe shqiptimi i masave ndaj nxënësve;
- Mentorimin dhe monitorimin e orëve mësimore si dhe vlerësimin e performancës së mësimdhënësve dhe stafit tjetër administrativ-technik, në mënyrë objektive, për çdo vit shkollor, duke e vendosur një kopje të këtij vlerësimi në dosjen e secilit punëtor dhe përgadit një raport të përgjithshëm me rekomandime për DKA-në;
- Pjesëmarrjen në panelin për pranimin e kuadrit në shkollë;
- Nxjerjen e vendimeve për themelimin e komisioneve të ndryshme në interes të shkollës;
- Kryerjen e detyrave tjera të ngarkuara nga ana e DKA-së dhe obligimet e përcaktuara me akte tjera normative.

Kushtet:

- Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
- Të kenë të kryer së paku arsimin universitar të nivelit themelor (së paku kualifikimin prej 240 ECTS/4 vite të shkollimit universitar) nga profilet e pranueshme për pozitën e mësimdhënësit sipas Udhëzimit për licencimin e mësimdhënësve dhe normativit mbi punësimin e kuadrit mësimor dhe rregullativës tjetër ligjore;
- Të kenë licencë të rregullt të mësimdhënësit dhe ata që janë në procedurë të licencimit;
- Të kenë të përfunduar me sukses një program të akredituar të kualifikimit profesional për udhëheqje, administrim ose menaxhim e noterizuar ose e vërtetuar;
- Të kenë së paku 3 vite përvojë pune në arsim ose në institucione të arsimit;

Aplikacioni duhet të përmbajë:

- Dokumentet personale (certifikatën e lindjes dhe letërnjoftimi ose pasaporta);
- Diplomën e kualifikimit (ose certifikat) e noterizuar ose e vërtetuar;
- Certifikatat e trajnimeve të përfunduara;
- Dëshmi se ka licencë të mësimdhënësit ose që është në procedurë të licencimit;
- Dëshmi të përvojës së punës në arsim;
- Portfolion profesionale (sipas udhëzimeve në shtojcën G të UA 08/2014);
- Letër reference nga një institucion publik-kredibil (si MASHT, DKA, Këshilli Drejtues i shkollës, punëdhënësi paraprak, institucionet e arsimit të lartë). Letrat e referencës duhet të kenë përmbajtje dëshmuese për punën dhe angazhimet paraprake;
- Planin zhvillimor të institucionit edukativo-arsimor dhe aftësues për të cilin konkurron (së paku 10 faqe tekst me hapësirë 1.5, fonti i shkronjave Arial madhësia 12) sipas udhëzimeve të MASHT;
- Certifikatën shëndetësore të lëshuar nga një institucion publik shëndetësor me të cilën dëshmohet gjendja shëndetësore e kandidatit - origjinale;
- Dëshminë se nuk është nën hetime - origjinale.

Data e shpalljes së konkursit **18/07/2019** deri me dt. **01/08/2019**

Aplikacioni për konkurrim merret në zyrën e DKA-së, kati i parë, sporteli nr. 10-12, Formularët të plotësoshëm rrjedhshëm në gjuhën shqipe dhe me shkronja të mëdha të shtypit. Dokumentacioni i kompletuar, dorëzohet në arkivin komunal, ndërsa dokumentet e pakompletuara dhe ato që arrijnë pas afatit të konkurimit nuk do të shqyrtohen. Konkursi mbetet i hapur 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga data e shpalljes në shtypin ditor dhe në medie elektronike.



U.D. Udhëheqëse e Personelit
Hanimshahë Shabani



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA DRENAS
Zyra e Kryetarit
Udhëheqësi i Personelit
01Nr. 111/21-41290 dt. 18/07/2019



Në bazë të nenit 11 paragrafi 1, nenit 18, paragrafi 1 të Ligjit Nr.03/L-149 të Shërbimit Civil të Republikës së Kosovës, Ligjit nr.04/L-032 Për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Ligjit nr.03/L-068 Për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës dhe në bazë të nenit 2 paragrafi 7 të Udhëzimit Administrativ të MASHT-it, nr.08/2014 për procedurat dhe kriteret e zgjedhjes së Drejtorit dhe Zv.Drejtorit të institucionit edukativo-arsimor dhe aftësues, Sektori i Burimeve Njerëzore, Komuna e Drenasit, shpallë këtë:

KONKURS PUBLIK PËR PLOTËSIMIN E POZITËS SË PUNËS

DREJTORIA E ARSIMIT

I.Titulli i vendit të punës: **Drejtör shkollë fillore të mesme të Ulët (SHFMU)**
„Rexhep Gjeli” Likoshan

Lloji i vendit të punës: **Me mandat**
Numri i Pozitave: **1 (një) pozitë**
Kategoria Funktionale: **Nivël drejtues**
Koefficienti: **7.8**
Kohëzgjatja e emërimit: **Katër (4) vjet**

Qëllimi i vendit të punës:

Udhëheqja, menaxhimi dhe mbikëqyrja e institucionit edukativo-arsimor

DETYRAT KRYESORE TË PUNËS:

- Menaxhimin dhe administrimin e përgjithshëm të institucionit;
- Hartimin e planit vjetor të punës dhe planit zhvillimor të institucionit, të cilin e miraton Këshilli drejtues i shkollës;
- Kordinimin dhe bashkëpunimin me aktivet profesionale për ndarjen e normave dhe orëve për mësimdhënës/edukatorë, caktimin e kujdestarëve të klasave, kujdestarëve të dites si dhe kërkim raportim prej tyre;
- Caktimin e detyrave për zgjedhjen, vlerësimin, disiplinën dhe çështjet tjera që kanë të bëjnë me mësimdhënësit dhe punëtorët tjerë edukativo-arsimor, konform legjislacionit në fuqi si dhe caktimi dhe shqiptimi i masave ndaj nxënësve;
- Mentorimin dhe monitorimin e orëve mësimore si dhe vlerësimin e performancës së mësimdhënësve dhe stafit tjetër administrativ-technik, në mënyrë objektive, për çdo vit shkollor, duke e vendosur një kopje të këtij vlerësimi në dosjen e secilit punëtor dhe përgadit një raport të përgjithshëm me rekomandime për DKA-në;
- Pjesëmarrjen në panelin për pranimin e kuadrit në shkollë;
- Nxjerjen e vendimeve për themelimin e komisioneve të ndryshme në interes të shkollës;
- Kryerjen e detyrave tjera të ngarkuara nga ana e DKA-së dhe obligimet e përcaktuara me akte tjera normative.

Kushtet:

- Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
- Të kenë të kryer së paku arsimin universitar të nivelit themelor (së paku kualifikimin prej 240 ECTS/4 vite të shkollimit universitar) nga profilet e pranueshme për pozitën e mësimdhënësit sipas Udhëzimit për licencimin e mësimdhënësve dhe normativit mbi punësimin e kuadrit mësimor dhe rregullativës tjetër ligjore;
- Të kenë licencë të rregullt të mësimdhënësit dhe ata që janë në procedurë të licencimit;
- Të kenë të përfunduar me sukses një program të akredituar të kualifikimit profesional për udhëheqje, administrim ose menaxhim e noterizuar ose e vërtetuar;
- Të kenë së paku 3 vite përvojë pune në arsim ose në institucione të arsimit;

Aplikacioni duhet të përmbajë:

- Dokumentet personale (certifikatën e lindjes dhe letërnjoftimi ose pasaporta);
- Diplomën e kualifikimit (ose certifikat) e noterizuar ose e vërtetuar;
- Certifikatat e trajnimeve të përfunduara;
- Dëshmi se ka licencë të mësimdhënësit ose që është në procedurë të licencimit;
- Dëshmi të përvojës së punës në arsim;
- Portfolion profesionale (sipas udhëzimeve në shtojcën G të UA 08/2014);
- Letër reference nga një institucion publik-kredibil (si MASHT, DKA, Këshilli Drejtues i shkollës, punëdhënësi paraprak, institucionet e arsimit të lartë). Letrat e referencës duhet të kenë përmbajtje dëshmuese për punën dhe angazhimet paraprake;
- Planin zhvillimor të institucionit edukativo-arsimor dhe aftësues për të cilin konkurron (së paku 10 faqe tekst me hapësirë 1.5, fonti i shkronjave Arial madhësia 12) sipas udhëzimeve të MASHT;
- Certifikatën shëndetësore të lëshuar nga një institucion publik shëndetësor me të cilën dëshmohet gjendja shëndetësore e kandidatit - origjinale;
- Dëshminë se nuk është nën hetime - origjinale.

Data e shpalljes së konkursit **18/07/2019** deri me dt. **01/08/2019**

Aplikacioni për konkurrim merret në zyrën e DKA-së, kati i parë, sporteli nr. 10-12, Formularët të plotësoshëm rrjedhshëm në gjuhën shqipe dhe me shkronja të mëdha të shtypit. Dokumentacioni i kompletuar, dorëzohet në arkivin komunal, ndërsa dokumentet e pakompletuara dhe ato që arrijnë pas afatit të konkurimit nuk do të shqyrtohen. Konkursi mbetet i hapur 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga data e shpalljes në shtypin ditor dhe në medie elektronike.



U.D. Udhëheqëse e Personelit
Hanimshahë Shabani

E rrallë

Ngordhje masive e zogjve

Më shumë se 60 zogj kanë ngordhur. Dyshohet se ngjarja ka ndodhur për shkak të helmimit në Australinë e Jugut. Shpendët, dy specie të korelës, u zbuluan në afërsi të një fushe sportive në Adelaide të martën dhe të mërkurën. Ngordhja e tyre po hetohet nga departamentet qeveritare.



FOTO E DITES



Hëna e plotë vë në pah anijen bregdetare me njerëz në Kansas City në Misuri. Fotografia është publikuar në "Zëri i Amerikës".

E jashtëzakonshme

Hidhet nga ujëvara e Nivarës dhe mbijeton

Një burrë ka arritur t'i mbijetojë mrekullisht rënies nga lartësia 57 metra në ujëvarën e Nigarës. Autoritetet iu përgjigjen thirrjes së një burrë ishte në rrezik në Horseshoe Falls. Ai u ngjit në një mur dhe më pas u hodh në lumin e Nigarës para se të zhdukej. Mrekullisht gjatë kërkimit në lumë ai u gjet në një shkëmb.



BARSOLETA E DITËS



Pacienti: Doktor, a shkoj mirë operacioni?

Doktori: Miku im, unë jam engjëlli.



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Ne ora 16:00 (vikendit ne ora 14:00 dhe 16:00)

"THE SECRET LIFE OF PETS 2" 3D

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 ore 26 min

Rolet: Kevin Hart, Tiffany Haddish, Harrison Ford, Patton Oswalt, Eric Stonestreet, Jenny Slate, Lake Bell, Hannibal Buress, Nick Kroll, Dana Carvey, Ellie Kemper, Pete Holmes, Garth Jennings, Bobby Moynihan

Regjia: Chris Renaud and Jonathan Del Val



Ne ora 18:00

"X-Men; Dark Phoenix"

Aksion/Aventurë/Sci-Fi; 1 orë 53 min

Rolet: James McAvoy, Michael Fassbender, Jennifer Lawrence, Nicholas Hoult, Sophie Turner, Tye Sheridan, Alexandra Shipp, Kodi Smit-McPhee, Evan Peters, and Jessica Chastain

Regjia: Simon Kinberg



Në ora 20:00

"MEN IN BLACK; INTERNATIONAL" 3D,

Aksion/Komedi/Sci-Fi; 1 orë 55 min

Rolet: Chris Hemsworth, Tessa Thompson, Kumail Nanjiani, Rebecca Ferguson, Rafe Spall, Laurent Bourgeois, Larry Bourgeois, Emma Thompson, Liam Neeson

Regjia: F. Gary Gray



Ne ora 22:00

"M A"

Horror/Triller; 1 ore 39 min

Rolet: Octavia Spencer, Juliette Lewis, Diana Silvers, Luke Evans, McKaley Miller, Missi Pyle, Corey Fogelmanis, Gianni Paolo, Dante Brown

Regjia: Tate Taylor



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.



DASHI

Fokusohuni te financat sot sepse çdo gjë


tjetër do të shkojë qetë gjatë ditës. Edhe pse jeni të shqetësuar për një problem, do t'i jepni zgjidhje.



DEMI

Një çështje e rëndësishme

biznesi sot do t'ju mbajë nën tension gjatë gjithë ditës. Nuk do t'i jepni dot zgjidhje të shpejtë.



BINJAKËT

Edhe pse sot jeni disi

ëndërrimtar, përsëri nuk e keni humbur kontaktin me realitetin. Qëndroni me këmbë në tokë.



GAFORRJA

Çaste kreativiteti sot për ju dhe

qëndrim në ambiente artistike ku doni të mësoni gjëra të reja.



LUANI

Sot nuk jeni të kënaqur nga ana

sentimentale. Ndjenjat që provoni për dikë nuk kompensohen në mënyrë reciproke dhe kjo gjë ju mërzit.



VIRGJËRESHA

Dita juaj sot nuk ka vetëm

ngjyrat e entuziazmit që ju shoqëron gjithmonë, por edhe ato të pasionit. Jeni shumë sharmant.



PESHORJA

Tensionet dhe keqkuptimet e të

shkuarës dalin më në pah gjatë ditës së sotme. Debate të ashpra priten gjatë pjesës së dytë të ditës.



AKREPI

Sot ndiheni romantik dhe doni të

qëndroni vetëm pranë njeriut të zemrës. Kushtet e ditës nuk jua lejojnë këtë gjë për shkak të angazhimeve.



SHIGJETARI

Më në fund keni filluar të

lëvizni në fushën e financave sepse po shikoni që të tjerët kanë marrë përfitimet e investimeve tuaja.



BRICJAPI

Miqtë do t'ju lënë

hapësira veprimi gjatë ditës së sotme sepse e dinë që ju keni qejf të bëheni protagonist në rrethin shoqëror.



UJORI

Mungesa e anës

financiare sot do t'jua vështirësojë punët, por ju nuk i shtrini këmbët asnjëherë më tepër se jorgani, kështu që do të menaxhoni ato që keni.



PESHQIT

Edhe pse sot është

ditë e zhurmshme ju ndiheni shumë plogësht. Nuk keni dëshirë fare t'u përkushtoheni impenjimeve tuaja.

Chance the Rapper flet për albumin e ri



Chance the Rapper është gati për ta lëshuar albumin e tij të ri. Reperi 26-vjeçar zbuloi titullin dhe datën e lëshimit gjatë


një paraqitje në The Tonight Show me Jimmy Fallon. Ai tregoi se albumi titullohet "The Big Day" dhe do të dalë të premten më 26 korrik.

Pas vdekjes, Cameron Boyce bëhet hi



Cameron Boyce është djegur pas vdekjes së tij në fillim të këtij muaji. Javën e kaluar u konfirmua se aktori vdiq nga një konfiskim epileptik. Cameron vdiq më 6 korrik dhe shumë nga

miqtë dhe kolegët e tij e nderuan dhe kujtuan atë në rrjete sociale. Gjatë fundjavës së kaluar, shumë njerëz morën pjesë në ceremoninë e përkujtimit të aktorit të ndjerë.



Joe Jonas përgëzon gruan për nominimin në Emmy Awards

Joe Jonas ka përgëzuar bashkëshorten e tij Sophie Turner me një mesazh të ëmbël pasi u nominua për një çmim Emmy. Aktorja 23-vjeçare është nominuar në kategorinë e "Aktorja

mbështetëse e përkohshme në një dramë seri", për punën e saj si Sansa Stark në Game of Thrones. Joe ka postuar në rrjetet sociale një storie duke thënë se ai ndihet shumë krenar për të.

Whoopi Goldberg tregon pse nuk e drejton makinën

Whoopi Goldberg ka shpjeguar pse nuk e drejton makinën. Aktorja 63-vjeçare zbuloi se ka një shofer privat për ta dërguar atë kudo që ka nevojë. "Kam një shofer. Arsyeja që unë kam një shofer është sepse nuk më lejohet të vozis. Sytë e mi nuk janë mirë. Pra nuk më lejohet", ka thënë ajo për "The View". Ky lajm vjen disa muaj pasi aktorja kishte probleme të mëdha shëndetësore, ndërsa vuante nga pneumia.



>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Neki Hoti shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën e SHM "12 maji" Ratkoc

► Arsim Zabeli shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme "Anton Çetta" Skenderaj drejtimi Tregti.

► Veton Thaqi shpalle te pavlefshëm diplomën e fakultetit ekonomik -Menaxhment-Ndërkombëtar nr. i diplomës 365/ 2015.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qera ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokalim më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

EURO GLASS
 SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
 Enveri
 Adr: Fushë Kosovë
 Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
 E-mail: euro.glass@live.com

Sport

QENDRA SPORTIVE
 "BUJQËSIA"
 TEL: 045/82 82 82

Prezantohet ekipi olimpik, synohen medalje në 'Baku 2019'

18 sportistë nga sporte të ndryshme do ta përfaqësojnë Kosovën në Festivalin Olimpik Evropian për të Rinj (EYOF) "Baku 2019". Në këto lojëra ekipi i Kosovës po synon të fitojë medalje. "Pritshmëritë për rezultate të mira janë edhe nga atletika, por që ne nuk do t'i bëjmë askujt presion. Ne kërkojmë sjellje të mirë dhe dhënie të maksimumit nga secili sportist", ka thënë Besim Hasani, kryetar i KOK-ut



EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 18 KORRIK - Kosova do të marrë pjesë në Festivalin Olimpik Evropian për të Rinj (EYOF) "Baku 2019" nga 21 deri më 27 korrik. Ndërsa të enjten është prezantuar ekipi olimpik i Kosovës që përbehet 18 sportistë të moshës 15-18-vjeçare. Listës i prin xhudistja Erza Muminoviq që në Buenos Aires 2018 e fitoi medaljen e bronzit. "Përgatitjet janë bërë shumë më herët nëpër federata falë mbështetjes nga mjetet që gjeneron KOK-u. Nëse e shikojmë të kaluarën e sukseseve, nga xhudo kemi rezultatet më të mira edhe te seniorët, edhe te kategoritë e reja, por që befasi e këndshme së fundi është medalja e artë e Muhamet Ramadanit nga Kampionati Ballkanik i Atletikës, prandaj pritshmëritë për rezultate të mira janë edhe nga atletika, por që

ne nuk do t'i bëjmë askujt presion. Ne kërkojmë sjellje të mirë dhe dhënie të maksimumit nga secili sportist", ka thënë kryetari i Komitetit Olimpik të Kosovës, Besim Hasani. Noti përfaqësohet me pesë sportistë. Me nga një garues më pak përfaqësohen sporti i atletikës dhe tenisi, kurse mundja do të përfaqësohet me dy sportistë. Trajneri i mundjes, Ziber Xhoni, e ka përgëzuar Komitetin Olimpik të Kosovës për mundësinë që iu dha për t'u përgatitur për EYOF Baku 2019, kurse ka shprehur besimin se nga ky festival ekipi i Kosovës do të kthehet me medalje. Për Kosovën, Festivali Olimpik Evropian Veror për të Rinj është i treti pas përfaqësimit në "Tbilisi 2015" dhe "Gyor 2017". "Baku 2019" është rasti i artë që ekipi olimpik i Kosovës ta fitojë medaljen e parë, e cila i mungon vendit tonë në festivale të tilla.

LISTA E EKIPIT OLIMPIK TË KOSOVËS PËR EYOF BAKU 2019

Erza Muminoviq	(xhudo)
Fatona Kasapi	(xhudo)
Festim Beqiri	(xhudo)
Muhamet Ramadani	(atletikë)
Leon Thaqi	(atletikë)
Albina Bojaxhiu	(atletikë)
Djellza Selaci	(atletikë)
Urim Qaili	(mundje)
Njomëza Krasniqi	(mundje)
Vigan Bytyqi	(not)
Olt Kondirolli	(not)
Hana Fejzullahu	(not)
Jona Macula	(not)
Elona Zhugolli	(not)
Melos Nallbani	(tenis)
Fresk Sylhasi	(tenis)
Vesa Gjinaj	(tenis)
Forta Morina	(tenis)

TRAJNERËT:

Fatos Tabaku	(xhudo)
Xhavit Tahiri	(atletikë)
Ardian Hamiti	(not)
Festim Ibrahim	(tenis)
Ziber Xhoni	(mundje)

SHKURT

Notarët e Kosovës në Korenë e Jugut

Tre notarët e Kosovës, Fjorda Shabani, Dren Ukimeraj dhe Eda A. Zeqiri, do ta përfaqësojnë Kosovën në Kampionatin Botëror që po mbahet në Gwangju të Koresë së Jugut. Garuesit e Kosovës garat i fillojnë më 22 korrik.

Ferizaj sot fillon përgatitjet

Skuadra e Ferizajt sot (e premte) do t'i fillojë stërvitjet për sezonin e ri. Stërvitjet do të fillojnë nga ora 17:00 në stadiumin me bari sintetik (mbra-pa sallës së sportit "Bill Clinton"). Në stërvitje sotme do të jenë shumica e futbollistëve që ishin pjesë e klubit edhe në sezonin e kaluar. Ndërsa gjatë ditëve në vazhdim do të prezantohet edhe disa përforcime të reja të cilët janë të njohur për futbollin vendor.

Real Madridi transferon Kosovare Asllanin

Futbollistja shqiptare Kosovare Asllani është larguar nga Linkopingu i Suedisë për t'u transferuar në ekipin spanjoll CD Tacon i cili nga sezoni 2020/21 do të quhet Real Madrid. "Kosovare Asllani është futbolliste e re e CD Tacon. Mirëserdhe", ka shkruar klubi spanjoll në rrjetet sociale. Ajo kishte edhe pesë muaj kontratë me klubin suedez, por e shkëputi atë para kohe për t'u transferuar në Spanjë. "Dua ta falënderoj Linkopingun me të cilin e kam nënshkruar kontratën e parë që kur isha 17-vjeçare. Dua t'i falënderoj tifozët e klubit dhe t'i uroj fat dhe suksese skuadrës në të ardhmen", ka thënë Asllani.

Xhaka projektohet kapiteni i Arsenalit për sezonin e ri

Arsenali mposhti 2-1 Bayernin e Mynihut në miqësoren e zhvilluar në Los Angeles falë të riut Eddie Nketiah, që shënoi golin e dytë për "Topçinjtë" në minutën e 88-të, ndërsa më parë kishin realizuar Poznanski autogol dhe Robert Lewandowski. Në këtë sfidë, mesfushori shqiptar Granit Xhaka mbajti shiritin e kapitenit, çka tregon se ai mbetet në "pole" për rolin e liderin gjatë sezonit të ri, pas qëndrimit të francezit Laurent Koscielny për t'u larguar me çdo kusht nga Arsenali (nuk udhëtoi me skuadrën për fazën përgatitore. Edhe nëse veterani francez qëndron, s'mund ta mbajë më shiritin e kapitenit. Trajneri i Arsenalit, Unai Emery, po planifikon të ndërtojë një tjetër grup udhëheqës prej pesë lojtarësh, mes të cilëve Xhaka duket i më i mundshmi për ta marrë rolin e liderit pata emrave të tillë si Sokratis, Nacho Monreal dhe Mesut Ozil.

Pensionohet Armend Dallku

PRISHTINË, 18 KORRIK - Kapiteni i Prishtinës, Armend Dallku, është pensionuar nga futboli aktiv. Lajmi është bërë me dije nga faqja zyrtare e skuadrës nga kryeqyteti, kurse Dallku do të mbetet pjesë e Prishtinës në shtabin teknik. "Armendi mund të jetë dukur i ashpër, por Armendin e

vërtetë e çmojnë të gjithë. Si me disiplinën jashtëzakonisht profesionale në training, si për angazhimin në fushë, si për mikun e madh të çdonjërit jashtë fushës në jetën e përditshme. Armendi do t'i mungojë fushës së blertë, por me Armendin Prishtina do të vazhdojë bashkëpunimin

edhe shumë më tej", thuhet në njoftim të klubit nga kryeqyteti i Kosovës. 36-vjeçari, përveç për Prishtinën, ka luajtur edhe për Elbasanin dhe Vorskla Poltavan. Ndërsa për Kombëtaren e Shqipërisë është paraqitur në 64 ndeshje dhe ka shënuar një gol.



Hendbollistet U19 lëshuan fitoren nga duart

PRISHTINË, 18 KORRIK - Përfaqësuesja U19 e Kosovës në hendboll (femrat) ka lëshuar rast të mirë për të arritur fitore në kampionatin evropian, Divizioni B, i cili po mbahet në Lituani. Vashat e Kosovës pësuan nga Ishujt Faroe me rezultat 23:22. Në fund të ndeshjes Kosova kishte disa aksione për ta barazuar rezultatin e pse jo edhe për të kaluar në epërsi, por i mungoi fati. Për

dallim nga ndeshja e kaluar, vashat U19 e kanë dhënë maksimumin dhe ishin vazhdimisht të barabarta me lojtaret e Ishujve Faroe. Kanë ndikuar edhe disa gabime teknike, që ishin dukshëm më të vogla se në ndeshjen e kaluar. Në pjesën e parë Kosova kishte epërsi deri në dy gola, por në fund rezultati ishte 14:13 për Ishujt Faroe. Në pjesën e dytë është luftuar për çdo gol, por në mungesë të

fatit nuk kemi shënuar golin e barazimit dhe pësuar me rezultat 23:22. Ishte kjo bindshëm paraqitja më e mirë e Kosovës U19 në evropianin në Lituani. Me paraqitje të mirë është shquar portierja Leonita Gashi që bëri plot 17 pritje. Shumica e golave janë realizuar nga motrat Rexhepi. Sara i shënoi 9 gola, kurse Rina 8. Tani Kosova i ka edhe dy ndeshje për plasman përfundimtar.



Kastrati: Do ta japim maksimumin për Kosovën

Prishtinë, 18 korrik - Basketbollistet e Kosovës po i vazhdojnë përgatitjet sipas planit për të qenë të gatshëm para ndeshjeve me Luksemburgun dhe Britaninë e Madhe. Stërvitjet po vazhdojnë dy herë në ditë sipas planit, derisa gjatë kësaj fundjave do të zhvillojnë edhe dy ndeshje miqësore me Sllovakinë. Basketbollisti i Kosovës, Erjon Kastrati, ka folur për përgatitjet e deritanishme. "Përgatitjet po shkojnë shumë mirë deri më tani. Ne po japim maksimumin në stërvitje dhe do ta japim maksimumin edhe në ndeshje. Besoj se para ndeshjeve të muajt gusht do të përgatitemi 100% dhe do të jemi të gatshëm për takimet ndaj Luksemburgut dhe Britaninë e Madhe. Do të kemi edhe dy ndeshje miqësore që do të na ndihmojnë shumë", ka thënë Kastrati për faqen zyrtare të FBK-së.



që të jemi të gatshëm për këto ndeshje. Kam stërvitur gjatë gjithë verës dhe besoj se do të jem i gatshëm. Do të fillojmë t'i analizojmë kundërshtarët me video për ta parë fuqinë e tyre. Gjithsesi, ne do të japim më të mirën tonë. Shpresoj se do ta kemi ndihmën e publikut ashtu si deri më tani. Tifozët në Mitrovicë janë të njohur për

atmosferën e jashtëzakonshme që e krijojnë dhe shpresoj se do të na përkrahin maksimalisht", përfundoi Erjon Kastrati. "Dardanët" më 3 gusht janë mysafirë të Luksemburgut, më pas e presin Britaninë e Madhe më 7 gusht dhe Luksemburgun më 14 gusht, kurse ndeshja e fundit është kundër Britanisë në udhëtim më 17 gusht.

Kjo është renditja e re e tenistëve pas Wimbledonit



Londër, 18 korrik - Pas përfundimit të grand slamit të Wimbledonit nuk ka pasur ndryshime të mëdha në renditjen botërore për meshkuj dhe femra në tenis. Në të dyja kategoritë, në krye të renditjes qëndrojnë Novak Djoković dhe Ashleigh Barty. Serbi, triumfues në turneun londinez, ka mbrojtur pikët dhe kreun e renditjes, duke lënë pas Nadalën e Federerën. Ndryshimi i vetëm

është rokada mes Thiem e Zverevit, me austriakun që parakalon gjermanin në vendin e katërt. Te femrat, Barty ruan kreun edhe pse u eliminua në raundin e katërt të Wimbledonit. Po ashtu, edhe Osaka ruan vendin e dytë, por tashmë tenistet që vijnë nga pas janë shumë pranë. Halep fitoi 2000 pikë nga triumfi dhe ngjitet në vendin e katërt, duke synuar sërish kreun.

RENDITJA - TOP 5 MESHKUJ

1. Novak Djoković	12.145 pikë
2. Rafael Nadal	7.945 pikë
3. Roger Federer	7.460 pikë
4. Dominic Thiem	4.595 pikë
5. Alexander Zverev	4.325 pikë

RENDITJA - TOP 5 FEMRA

1. Ashleigh Barty	6.605 pikë
2. Naomi Osaka	6.257 pikë
3. Karolina Pliskova	6.055 pikë
4. Simona Halep	5.933 pikë
5. Kiki Bertens	5.130 pikë

SHKURT

Tottenhami e dëshiron Hysajn në vend të Trippierit

Kieran Trippier e ka lënë Tottenham Hotspurin për t'u transferuar tek Atletico Madrid. 28-vjeçari firmosi një kontratë trevjeçare dhe është gati ta nisë aventurën e re me ekipin e Diego Simeones. Shitja e lojtarit të kombëtares angleze detyron Tottenhamin të kërkojë një mbrojtës të djathtë. Dy janë objektivat sipas "Sportmediaset", Elseid Hysaj dhe Alessandro Florenzi. Shkodrani është drejt largimit nga Napoli, por nuk po arrin akordin me klubin e ri, pavarësisht prej interesimit të madh. Hysaj u përfol gjatë edhe për një kalim të Chelsea gjatë sezonit të kaluar, ndërsa tani mund të luajë me finalistët e Ligës së Kampionëve.

'Marça': Ronaldo, favorit për 'Topin e Artë'

Ylli portugez i Juventusit, Cristiano Ronaldo, është konkurrent për ta fituar "Topin e Artë". Kështu shkruan "Marca", në një analizë të gjatë për sezonin e Cristiano Ronaldos të Juventusit dhe të Kombëtarja e Portugalisë. Në bazë të opinionëve të para të mbledhura, Ronaldo duhet të jetë pranë triumfit personal, pasi vitin e kaluar Luka Modriç ndërpreu dominimin 10-vjeçar të portugezit dhe Lionel Messit. Sipas "Marcas", 34-vjeçari është një nga favoritët kryesor bashkë me Kylian Mbappe, Sadio Mane e Virgil Van Dijk.

De Ligt: Juven e zgjedha për shkak të mbrojtjes italiane

Pa dyshim se Matthijs De Ligt ka qenë personazhi kryesor në futbollin italian këto dy ditë e fundit. Holandezi është zyrtarisht një lojtar i Juventusit dhe është kthyer në një prej blerjeve më të bujshme të verës. Në një intervistë të dhënë për kanalën zyrtare të Ajaxit në televizion, De Ligt ka sqaruar pse ka zgjedhur Juventusin dhe jo një skuadër tjetër për ta vazhduar karrierën e tij. "Kam qenë gjithmonë i 'hipnotizuar' nga mënyra se si italianët mbrojnë. Ka shumë lojtarë që unë i ndjek si shembull, Maldini, Barezi, Nesta, Cannavaro, apo Shirea. Dhe unë u dashurova se si mbrojnë italianët", ka thënë De Ligt.

Interi heq dorë nga Lukakun, synon Cavanin

Interi e ka thyer interesimin nga sulmuesi i Paris Saint-Germain, Edinson Cavani. Manchester Unitedi vazhdon të kërkojë më shumë se 80 milionë euro për Lukakun, të cilat Interi nuk është i gatshëm t'i shpenzojë. "Tuttosport" dhe "Corriere dello Sport" pretendojnë se alternativa e yllit belg është Cavani. Ish-sulmuesi i Napolit shihet si një opsion më i lirë, pasi ai është 32-vjeçar dhe ka mbetur me vetëm edhe një vit në kontratën e tij me PSG-në. "Nerazzurrit" gjithashtu do të ishin në gjendje t'i ofrojnë atij një rrogë prej nëntë milionë eurosh, një rënie e lehtë në fitimet e tij aktuale prej 12 milionë eurosh në sezon.

Ronaldinho, afër rikthimit pas katër vjetësh

Një lajm i pabesueshëm po qarkullon në media dhe ka lidhje me Ronaldinhon. Brazili i famshëm e mbylli karrierën në vitin 2015 dhe Fluminense ishte klubi i fundit me të cilin luajti. Rreth katër vjet ka që nuk luan, por ish-ylli i Barcelonës mund t'i rikthehet futbollit. "L-Argument" raporton se maltezët e Birkirkara po negociojnë me 39-vjeçarin dhe janë pranë marrëveshjes finale. Katër herë kampionët e Maltës po insistojnë për t'i mbushur mendjen brazilianit për t'iu rikthyer fushave të blerta. Negociatat janë në rrugën e mbarë dhe shumë shpejt mund të kemi mundësinë për t'i shijuar përsëri magjitë e Ronaldinhos, pavarësisht se në një kampionat modest.



REPUBLIKA E KOSOVËS

KOMUNA E ZVEÇANIT

Në bazë të nenit 11 dhe 12 të Ligjit për Shërbimin Civil nr. 03/L-149 dhe nenit 3 dhe 4. Rregullores për procedurat e rekrutimit në shërbimin civil Nr.02/2010, si dhe nenin 8. Paragrafi 1 i Ligjit të Punës nr. 03 / L-212, Neni 3. Paragrafi 1 i Udhëzimit Administrativ për Rregullimin e Procedurave të Punësimit në Sektorin Publik (Nr.07 / 2017), nenit 5 Ligjit Nr. 03 / L-068 për Arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës, Komuna Zveçan, me datë 19.07.2019, shpall:

KONKURS PËR PRANIM NË MARRËDHËNIE PUNE

1. Emri vendin e punës:	Zyrtar Ligjor 2
Kodi:	LI/060
Grade:	9
Koeficienti:	7
Lloji i pozitës:	Karijere
Numri i ekzekutuesve:	1
Orët e punës:	40 orë në javë

Kualifikimet dhe aftësitë e kërkuara

- Diplomë universitare në fakultetin juridik, administratë publike dhe të paktën dy (2) vjet përvojë pune profesionale

2. Emri vendin e punës :	Administrator i TI-së për Baza të të Dhënave
Kodi:	TIK/350
Grade:	9
Koeficienti:	7
Lloji i pozitës:	Karijere
Numri i pozicioneve:	1
Orët e punës:	40 orë në javë

Kualifikimet dhe aftësitë e kërkuara

- Diplomë nga fusha e shkencave të informatikës ose fusha të ngjashme, së paku 2 vjet përvojë pune profesionale nga kjo fushë

3. Emri vendin e punës :	Udhëheqës i Sektorit për arsim
Kodi:	AR/340
Grade:	7
Koeficienti:	8.5
Lloji i pozitës:	Karijere
Numri i ekzekutuesve:	1
Orët e punës:	40 orë në javë

Kualifikimet dhe aftësitë e kërkuara

Diplomë Universitare në fushën e drejtësisë , shkenca shoqërore, administratë publike ose fusha të ngjashme, 4 (katër) vjet përvojë pune profesionale

4. Emri i vendit të punës:	Zyrtar për logjistikë 4
Kodi:	AD/120
Grade:	11
Koeficienti:	6
Lloji i pozitës:	Karijere
Numri i ekzekutuesve:	1
Orët e punës:	40 orë në javë

Kualifikimet dhe aftësitë e kërkuara

- Diplomë universitare e fakultetit ekonomik pa përvojë ose diplomë bachelor me të paktën dy (2) vjet përvojë pune profesionale

5. Emri i vendit të punës:	Zyrtar për mbrojtje të mjedisit
Kodi:	UNM/090
Grade:	9
Koeficienti:	6
Lloji i pozitës:	Karijere
Numri i ekzekutuesve:	1
Orët e punës:	40 orë në javë

Kualifikimet dhe aftësitë e kërkuara

- Diplomë universitare në fushën e mbrojtjes së mjedisit, teknologjise dhe ruajtjes së biodiversitetit, peizazhit ose fushave tjera të ngjashme, dy (2) vjet përvojë pune profesionale nga kjo fushë.

6. Emri i vendit të punës:	Pedagog
Fakulteti i Shkencave Shoqërore, dega e Pedagogjisë	
Numri i ekzekutuesve:	1
Orët e punës:	40 orë në javë
Vendi i punës, Institucioni parashkollor Lane, Zveçan	
Periodha e përfundimit të kontratës: Puna provuese 6 muaj me mundësi vazhdimi të kontratës.	

INFORMATA TË PËRGJITHSHME PËR KANDIDATËT LIDHUR ME PROCEDURËN E KONKURENCËS

Dokumentacioni i kërkuar:

- Aplikimi (mirret në zyrën nr.33 në ndërtesën e Komunës së Zveçanit)
- Një kopje të diplomës (e vërtetuar nga noteri)
- Një kopje të certifikatës së ekzaminimit të jurisprudencës - nëse kërkohet (vërtetuar nga noteri).
- Certifikata e përvojës së punës.
- Dy rekomandime (nëse ka).
- Një kopje të dy raporteve të fundit të vlerësimit punës (nëse ka).
- Konfirmimi se ai nuk ishte nën hetim dhe nuk u dënua për një vepër penale.
- Kopja e kartës së identitetit.
- Çertifikatat.

Informata të detajuara për të gjitha pozicionet me përshkrime të vendeve të punës, kualifikimet e kërkuara, përvojën e punës dhe aftësitë e tjera mund të merren në zyrën nr. 33 në ndërtesën e komunës së Zveçanit, si dhe në faqen e internetit të komunës www.copstinazveccan.com.

Konkursi mbetet i hapur për 15 ditë kalendarike nga dita e publikimit, duke filluar nga data 19.07.2019. deri më 02.08.2019.

Kërkesat e dërguara pas mbylljes së konkursit nuk do të merren në konsideratë. Kërkesat e paplotësuara mund të refuzohen. / Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Kërkesat e pakompletuara mund të refuzohen /

Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuar, do të kontaktohet përmes (e-mail) ose në mungesë të një konfirmimi email nga kandidati, ata do të njoftohen me telefon dhe janë të detyruar të sjellin me vete dokumente origjinale të kualifikimit dhe trajnimeve të kandidatit e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen. Në rast të moskryerjes së dokumentacionit origjinal, kandidatët do të përjashtohen nga procedura e rekrutimit.

"Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë/

"Komunitetet jo shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale, siç specifikohet në Nenin 11, paragrafin 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 mbi Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës"

Aplikacionet mund të merren- shkarkohen dhe dorëzohen çdo ditë pune në Zyrën nr. 33 në ndërtesën e Komunës së Zveçanit - rruga Kralj Milutini p.n. në periudhën nga ora 8:00 deri në orën 14:00

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania "Ramadani" Sh.p.k Krushë e Madhe, Rahovec, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për seperimin e zhavorrit dhe gurthyes në Krushë të Madhe komuna e Rahovecit.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 15.08.2019 në ora 11:00 në hapësirat e restorant "Lenar 1" Krushë e Madhe komuna e Rahovecit do të organizohet debat publik nga kompania "Ramadani" Sh.p.k Krushë e Madhe, Rahovec, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për seperimin e zhavorrit dhe gurthyes në Krushë të Madhe komuna e Rahovecit.

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.



REPUBLIKA KOSOVA
OPŠTINA ZVEČAN

Na osnovu člana 11. i 12. Zakona o Civilnoj Službi br.03/L-149 i člana 3. i 4. Pravilnika o Procedurama Regrutovanja u Civilnoj Službi br. 02/2010, kao i člana 8. Stav 1. Zakona o radu br. 03/L-212, člana 3. Stav 1. Administrativnog uputstva za regulisanje procedura radnog odnosa u javnom sektoru (Br.07/2017), člana 5 Zakona br 03/L-068 o obrazovanju u opštinama Republike Kosova, Opština Zvečan, dana 19.07.2019. godinc objavljuje:

KONKURS ZA PRIJEM U RADNI ODNOS

1. Naziv radnog mesta:	Pravni sluzbenik 2
Kod:	LI/060
Grejd:	9
Koeficijent:	7
Vrsta pozicije:	Karijere
Broj pozicija:	1
Radno vreme:	40 časova nedeljno.

Kvalifikacije i zahtevane sposobnosti

- Univerzitetska diploma pravnog fakulteta, javne administracije, najmanje 2 godine profesionalnog radnog iskustva

2. Naziv radnog mesta :	Administrator i IT za bazu podataka
Kod:	TIK/350
Grejd:	9
Koeficijent:	7
Vrsta pozicije:	Karijere
Broj pozicija:	1
Radno vreme:	40 časova nedeljno

Kvalifikacije i zahtevane sposobnosti

- Diploma iz oblasti informatičkih nauka ili slične oblasti, minimum 2 godine profesionalnog iskustva iz ove oblasti

3. Naziv radnog mesta:	Rukovodilac sektora za obrazovanje
Kod:	AR/340
Grejd:	7
Koeficijent:	8.5
Vrsta pozicije:	Karijere
Broj pozicija:	1
Radno vreme:	40 časova nedeljno

Kvalifikacije i zahtevane sposobnosti

- Univerzitetska diploma iz oblasti prava, društvenih nauka, javne administracije ili slične oblasti, 4 (četiri) godine profesionalnog radnog iskustva

4. Naziv radnog mesta :	Sluzbenik logistike 4
Kod:	AD/120
Grejd:	11
Koeficijent:	6
Vrsta pozicije:	Karijere
Broj pozicija:	1
Radno vreme:	40 časova nedeljno

Kvalifikacije i zahtevane sposobnosti

- Univerzitetska diploma ekonomskog fakulteta bez iskustva ili becherol diploma i najmanje dve (2) godine radnog iskustva

5. Naziv radnog mesta:	Sluzbenik za zastitu sredine
Kod:	UNM/090
Grejd:	9
Koeficijent:	6
Vrsta pozicije:	Karijere
Broj pozicija:	1
Radno vreme:	40 časova nedeljno

Kvalifikacije i zahtevane sposobnosti

- Univerzitetska diploma u oblasti očuvanja prirode, tehnologije i zaštite biodiverziteta, pejzaža, ili druge srodne oblasti, dve (2) godine profesionalnog iskustva iz ove oblasti

6. Naziv radnog mesta:	Pedagog
Završen fakultet Društvenih nauka, osek	Pedagogija
Broj izvrsioca:	1
Radno vreme:	40 časova nedeljno
Mesto obavljanja rada:	Predškolska ustanova Lane, Zvečan
Period zaključenja ugovora:	Probni rad u trajanju od 6 meseci uz mogućnost produženja ugovora.

OPŠTE INFORMACIJE ZA KANDIDATE U VEZI SA PROCEDUROM KONKURISANJA

Tražena dokumentacija:

- Aplikacija (preuzima se u kancelariji br.33 u zgradi opštine Zvečan)
- Kopija diplome (overena od strane notara)
- Kopija uverenja o položenom pravosudnom ispitu-ukoliko se traži (overeno od strane notara).
- Potvrda o radnom iskustvu.
- Dve preporuke (ako imate).
- Kopija dva poslednja izveštaja o vrednovanju rada (ako takve postoje).
- Potvrda da nije pod istragom i da nije osuđivan za krivično delo.
- Kopija lične karte.
- Sertifikati.

Detaljne informacije o svim pozicijama sa opisom posla, traženim kvalifikacijama, randim iskustvom i ostalim veštinama, možete dobiti u kancelariji br. 33 u zgradi opštine Zvečan kao i veb stranici opštine www.eopstinazvecan.com

Konkurs ostaje otvoren 15 kalendarskih dana od dana objavljivanja, počev od 19.07.2019.god. do 02.08.2019.god.

Zahtevi poslani nakon zatvaranja konkursa neće se uzeti u obzir. Nekompletirani zahtevi mogu biti odbijeni. / Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Kërkesat e pakompletuara mund të refuzohen/

Zbog velikog broja dobijenih zahteva, biće pozvani samo kandidati koji su ušli u uži izbor, biće kontaktirani putem (e-maila) ili u nedostatku potvrđivanja email-om od strane kandidata, biće obavješteni putem telefona i dužni su da ponesu sa sobom originalna dokumenta o kvalifikacijama i izvršenim obukama. U slučaju nedostavljanja originalne dokumentacije, kandidati će biti isključeni iz regrutacione procedure.

Civilna služba Kosova pruža jednake uslove zapošljavanja za sve državljane Kosova i prima aplikacije svih lica muškog i ženskog roda iz svih zajednica na Kosovu.

Manjinske zajednice i njihovi pripadnici imaju prava da budu predstavljani prporcionalno na organima Javne službe na lokalnom i centralom nivou, kao što je naznačeno i Čl.11, paragraf 3 Zakona Br.03/L-149 o Javnoj Službi Republike Kosova.

Aplikacije se mogu preuzeti i podneti svakog radnog dana u Kancelariji broj 33 u zgradi opštine Zvečan – ulica Kralja Milutina b.b. u periodu od 8:00 do 14:00 časova

C. nr.183/2019

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - Departamenti i përgjithshëm, Kryetari i trupit gjykues - Gjyqtari Ahmet Idrizaj, në çështjen juridike të paditësit Labinat (Iber) Shabanaj, nga fshati Dobrixhë, Komuna e Gjakovës, të cilin e përfaqëson i autorizuari Urim Pozhegu, avokat në Gjakovë, kundër të paditurës Florida (Muhamet) Shabanaj (e lindur Gashi), më parë nga Gjakova, tani në adresë të panjohur, të cilën e përfaqëson përfaqësuesi i përkohshëm Prenk Pepaj, avokat në Gjakovë, për zgjidhje të martesës, jashtë shqyrtimit me datë 17.07.2019, mori këtë:

AKTVENDIM

Të paditurës Florida (Muhamet) Shabanaj (e lindur Gashi), më parë nga Gjakova, tani në adresë të panjohur, **I CAKTOHET** përfaqësuesi i përkohshëm Prenk Pepaj, avokat në Gjakovë, i cili ka për obligim që të paditurën në fjalë të e përfaqëson në procedurën civile në lëndën C.nr.183/2019, sipas padisë të paditësit Labinat (Iber) Shabanaj, nga fshati Dobrixhë, Komuna e Gjakovës, me bazë juridike – zgjidhje e martesës dhe atë gjerë në momentin kur e paditura e lartpërmendur personalisht apo eventualisht ndonjë i autorizuar i saj, të lajmërohet në Gjykatë, ashtu që përfaqësuesi i përkohshëm mund të i ndërmerre të gjitha veprimet procedurale për të paditurën në fjalë të paraparë në bazë të Ligjit.

Andaj, luteni që përmbajtjen e këtij Aktvendimi siç është cekur më lartë ta publikoni në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës (ose në mungesë eventuale të saj), në ndonjërin nga të përditshmet ditore dhe lidhur me këtë të e njoftoni Gjykatën. Ky Aktvendim njëherit të publikohet edhe në tabelën e shpalljeve të kësaj Gjykate.

Andaj, Gjykata sipas propozimit të palës aktive në procedurë, gjeti se janë plotësuar kushtet nga neni 79.3 të LPK-së, për caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm të paditurit të lartë përmendur dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË
C.nr.183/2019 datë 17.07.2019

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES





Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Zyra e Kryeministrit –Ured Premijera –Office of the Prime Minister
Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agjencia za Statistiku Kosova - Statistical Agency of Kosovo

Bazuar në nenin 8 pika 3.1, nenit 6 pika 5 dhe nenit 33 të Ligjit Nr.04/L-036 për Statistikat Zyrtare të Republikës së Kosovës, Udhëzimit Administrativ Nr.08/2012 për kushtet dhe Mënyrën e Ofrimit të të Dhënave të Fituara me Përpunime të Veçanta të Statistikave Zyrtare si dhe nenit 12 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 03/ L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjin Nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, **Agjencia e Statistikave të Kosovës bënë:**

Shpalljen e Konkursit Publik për Marrëveshje për Shërbime të Veçanta

Emri i Institucionit	Agjencia e Statistikave të Kosovës
Titulli i pozitës(ave):	Anketues për MICS Pre-Test
Tarifa e shërbimit:	
Raporton te:	Kordinatorit për MICS anketën
Lloji i kontratës:	Marrëveshje për Shërbime të Veçanta - (MSHV)
Kohëzgjatja e kontratës:	Një (1) muaj
Orari i punës:	I plotë
Lokacioni dhe numri i anketuesve:	16 anketues (10 femra dhe 6 meshkuj)

Në kuadër të bashkëpunimit në mes të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK) dhe Fondacionit të Kombeve të Bashkuara për Fëmijë (UNICEF) për implementimin e Anketës së Treguesve të Shumëfishtë 2019 (MICS) në Kosovë, ASK ofron mundësinë e angazhimit për kandidatë të interesuar për punë në terren në regjionin e Prishtinës, sipas detyrave të përshkruara më poshtë.

Detyrat dhe përgjegjësitë e intervistuesve për MICS anketën:

- Të marrë pjesë në trajnime dhe të njihet me Udhëzimet Metodologjike dhe Organizative lidhur me pyetësorë e ekonomisë familjare, pyetësorë individual për gra dhe burra, pyetësorë për fëmijët nën moshën pesë vjeçare dhe pyetësorë për fëmijë të moshës 5-17 vjeçare;
- Të zhvillojnë grumbullimin e të dhënave për anketën e MICS me metodologjinë CAPI (Tablet);
- Të respektojnë udhëzimet e pyetësorit dhe të ndjekin të gjitha procedurat dhe sqarimet e përshkruara në udhëzime;
- Të punojnë në ekip dhe në koordinimi me udhëzimet e mbikqyrësit;
- Të njoftojnë mbikqyrësin për problemet dhe pasiguritë e mundshme gjatë punës në terren dhe të konsultohet për vazhdimin e punës;

Përgatitja shkollore dhe përvoja:

- Të jenë studentë apo të diplomuar;
- Komunikim i shkëlqyeshëm dhe shkathtësi ndërpersonale;
- Disponueshmëria dhe gatishmëria për të udhëtuar në të gjitha rajonet e Kosovës;
- Gatishmëria për të punuar në ekip;
- Përvojë në marrjen e matjeve antropometrike, kryerjen e intervistave ballë për ballë ose eksperiencë të anketimit në terren;

Kompetenca dhe aftësitë:

- Aftësi shumë të mirë gjuhësore (për të lexuar, shkruar dhe folur) në gjuhën shqipe ose serbe
- Aftësi të mira për të komunikuar dhe bashkëpunuar;
- Aftësi të mira për orientim në hapësirë (përdorimin e hartave për identifikimin e objekteve të banimit);
- Aftësi të mira organizative dhe sipas nevojës, të jetë i gatshëm të punojë me orarë pune fleksibil;
- Aftësi kompjuterike, Word, Excel, Internet etj;

Shënim: Kandidatët nga komunitetet Rom, Ashkalinje dhe Egjiptian me përgatitje shkollore më të ulët se diploma universitare, do të konsiderohen për vazhdim në proces.

Kushtet për aplikim:

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë Qytetarët e Republikës së Kosovës të moshës madhore (mbi 18 vjet) të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, janë në posedim të të drejtave civile dhe politike, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave dhe të cilët kanë aftësitë fizike që kërkohen për pozitën përkatëse.

Konkursi është i hapur 5 ditë kalendarike nga dita e publikimit në mjetet e informimit dhe në Ueb-faqen e ASK-së dhe UNICEF.

Si të aplikohet:

Online: Duke plotësuar të dhënat e kërkuara në linkun e mëposhtem:
<https://forms.gle/9VcsmvGCJReGWdW55>

Offline: CV, kopja e letërnjoftimit, dëshmia e të ndjekes së studimeve (vërtetimi nga fakulteti) ose diploma universitare dhe formulari i shkarkuar nga webfaqja e ASK <http://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/fund-faqe/mundesi-punesimi>, të dorëzohen në ASK

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen dhe duhet t'i nënshtrohen testimit me shkrim dhe intervistës.

Për më shumë informata lidhur me MICS vizitoni <http://mics.unicef.org>



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Zyra e Kryeministrit –Ured Premijera –Office of the Prime Minister
Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agjencia za Statistiku Kosova - Statistical Agency of Kosovo

Bazuar në nenin 8 pika 3.1, nenit 6 pika 5 dhe nenit 33 të Ligjit Nr.04/L-036 për Statistikat Zyrtare të Republikës së Kosovës, Udhëzimit Administrativ Nr.08/2012 për kushtet dhe Mënyrën e Ofrimit të të Dhënave të Fituara me Përpunime të Veçanta të Statistikave Zyrtare si dhe nenit 12 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 03/ L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjin Nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, **Agjencia e Statistikave të Kosovës bënë:**

Shpalljen e Konkursit Publik për Marrëveshje për Shërbime të Veçanta

Emri i Institucionit	Agjencia e Statistikave të Kosovës
Titulli i pozitës(ave):	Anketues për MICS Pre-Test
Tarifa e shërbimit:	
Raporton te:	Kordinatorit për MICS anketën
Lloji i kontratës:	Marrëveshje për Shërbime të Veçanta - (MSHV)
Kohëzgjatja e kontratës:	Një (1) muaj
Orari i punës:	I plotë
Lokacioni dhe numri i anketuesve:	16 anketues (10 femra dhe 6 meshkuj)

Në kuadër të bashkëpunimit në mes të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK) dhe Fondacionit të Kombeve të Bashkuara për Fëmijë (UNICEF) për implementimin e Anketës së Treguesve të Shumëfishtë 2019 (MICS) në Kosovë, ASK ofron mundësinë e angazhimit për kandidatë të interesuar për punë në terren në regjionin e Prishtinës, sipas detyrave të përshkruara më poshtë.

Detyrat dhe përgjegjësitë e intervistuesve për MICS anketën:

- Të marrë pjesë në trajnime dhe të njihet me Udhëzimet Metodologjike dhe Organizative lidhur me pyetësorë e ekonomisë familjare, pyetësorë individual për gra dhe burra, pyetësorë për fëmijët nën moshën pesë vjeçare dhe pyetësorë për fëmijë të moshës 5-17 vjeçare;
- Të zhvillojnë grumbullimin e të dhënave për anketën e MICS me metodologjinë CAPI (Tablet);
- Të respektojnë udhëzimet e pyetësorit dhe të ndjekin të gjitha procedurat dhe sqarimet e përshkruara në udhëzime;
- Të punojnë në ekip dhe në koordinimi me udhëzimet e mbikqyrësit;
- Të njoftojnë mbikqyrësin për problemet dhe pasiguritë e mundshme gjatë punës në terren dhe të konsultohet për vazhdimin e punës;

Përgatitja shkollore dhe përvoja:

- Të jenë studentë apo të diplomuar;
- Komunikim i shkëlqyeshëm dhe shkathtësi ndërpersonale;
- Disponueshmëria dhe gatishmëria për të udhëtuar në të gjitha rajonet e Kosovës;
- Gatishmëria për të punuar në ekip;
- Përvojë në marrjen e matjeve antropometrike, kryerjen e intervistave ballë për ballë ose eksperiencë të anketimit në terren;

Kompetenca dhe aftësitë:

- Aftësi shumë të mirë gjuhësore (për të lexuar, shkruar dhe folur) në gjuhën shqipe ose serbe
- Aftësi të mira për të komunikuar dhe bashkëpunuar;
- Aftësi të mira për orientim në hapësirë (përdorimin e hartave për identifikimin e objekteve të banimit);
- Aftësi të mira organizative dhe sipas nevojës, të jetë i gatshëm të punojë me orarë pune fleksibil;
- Aftësi kompjuterike, Word, Excel, Internet etj;

Shënim: Kandidatët nga komunitetet Rom, Ashkalinje dhe Egjiptian me përgatitje shkollore më të ulët se diploma universitare, do të konsiderohen për vazhdim në proces.

Kushtet për aplikim:

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë Qytetarët e Republikës së Kosovës të moshës madhore (mbi 18 vjet) të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, janë në posedim të të drejtave civile dhe politike, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave dhe të cilët kanë aftësitë fizike që kërkohen për pozitën përkatëse.

Konkursi është i hapur 5 ditë kalendarike nga dita e publikimit në mjetet e informimit dhe në Ueb-faqen e ASK-së dhe UNICEF.

Si të aplikohet:

Online: Duke plotësuar të dhënat e kërkuara në linkun e mëposhtem:
<https://forms.gle/9VcsmvGCJReGWdW55>

Offline: CV, kopja e letërnjoftimit, dëshmia e të ndjekes së studimeve (vërtetimi nga fakulteti) ose diploma universitare dhe formulari i shkarkuar nga webfaqja e ASK <http://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/fund-faqe/mundesi-punesimi>, të dorëzohen në ASK

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen dhe duhet t'i nënshtrohen testimit me shkrim dhe intervistës.

Për më shumë informata lidhur me MICS vizitoni <http://mics.unicef.org>